

Instituti për Studime të Avancuara GAP

Letërnjoftimi i Komunës së Prishtinës 2012

Qershor, 2012

“Letërnjoftimi i Komunave” është projekt i Institutit GAP i cili vlerëson qeverisjen komunale dy vite pas zgjedhjeve lokale të 2009. Ky projekt është implementuar në bashkëpunim me Rrjetin Ballkanik për Gazetari Hulumtuuese (BIRN) dhe Qendrën e Trajnimeve dhe Burimeve për Avokim (ATRC). Rezultatet e hulumtimeve të GAP për qeverisjen komunale janë debatuar me kryetarët e komunave në emisionet “Jeta në Kosovë”. Debati në “Jeta në Kosovë” për Komunën e Prishtinës është transmetuar në RTK më 7 qershor 2012.

Përmbajtja:

1. Përmbledhje ekzekutive	4
2. Pesë problemet më të mëdha të identifikuar gjatë fushatës elektorale 2009 .	6
2.1. Komunikacioni	6
2.2. Mungesa e ujit	7
2.3. Mirëmbajtja e banesave kolektive.....	7
2.4. Mungesa e hapësirave të gjelbëruara.....	8
2.5. Pamja e shëmtuar e qytetit.....	8
3. Performanca buxhetore e komunës së Prishtinës	9
4. Investimet kapitale.....	14
5. Arsimi.....	18
6. Shëndetësia.....	20
7. Administrata komunale.....	22
8. Transparenca.....	25
9. Puna e Kuvendit Komunal të Prishtinës.....	27
10. Raportet e Komunës së Prishtinës me pushtetin qendror	28
11. Përbushja e premtimeve të fushatës zgjedhore 2009	31
12. Sfidat më të mëdha me të cilat përballet komuna e Prishtinës.....	56
13. Burimet.....	57

Komuna e Prishtinës 2010-2011		
Nr.	10 të arriturat kryesore	10 dështimet më të mëdha
1	Zgjerimi dhe rregullimi i rrugës "Bill Clinton"	Mungesa e parkingjeve
2	Përfundimi i fazës së parë të rrugës "B"	Nuk është ndërtuar asnjë çerdhe publike
3	Gëlqerosja e ndërtesave publike	Transporti publik
4	Ndërtimi i bibliotekës së qytetit "Hivzi Sylejmani"	Mos ndërtimi i 12 fushave sportive në "Fushën e Pajtimit" ashtu siç ishte premtuar
5	Mënjanimi i ndërrimit të tretë në shkollat fillore dhe të mesme	Pamundësia për të ndalë ndërtimet pa leje dhe për të mbrojtur pronën publike
6	Rregullimi i rrugës "Ibrahim Fehmiu" në "Kodër të Trimave";	Mungesa e Planit Zhvillimor Komunal dhe Planit Zhvillimor Urban
7	Rregullimi i sporteleve të administratës në objektin e vjetër të komunës	Mos ndërtimi i unazës së jashtme të Prishtinës
8	Rregullimi i kolektorit në lumin Prishtevka në lagjen "Gollapi" dhe në lagjen "Kalabria"	Paaftësia e Komunës për t'i heq rrethojat e Kuvendit dhe Qeverisë për shtrirjen e sheshit "Ibrahim Rugova"
9	Hartimi i projekteve detale për sheshin "Ibrahim Rugova" dhe "Zahir Pajaziti"	Mungesa e ngrohjes qendrore
10	Ndërrimi i semaforëve dhe vendosja e semaforëve të rinjë në disa nyje të Prishtinës	Furnizimi jo i rregullt me ujë të pijes

1. Përmbledhje ekzekutive

Kryetari aktual i Prishtinës Isa Mustafa (LDK) po përmbyll vitin e tretë të mandatit të dytë në pozitën e kreut të Komunës së Prishtinës. Gjatë zgjedhjeve të fundit lokale të mbajtura në nëntor të vitit 2009 z.Mustafa fitoi zgjedhjet pa balotazh. Fitimi i mandatit të dytë si kryetar i Prishtinës ishte parë nga ai si mundësi e mirë për të realizuar programin e tij elektoral, sidomos pasi që mandati i dytë do të zgjas katër vite dhe jo dy vite si mandati i parë.

Në mandatin e parë të qeverisjes së Prishtinës nga z.Isa Mustafa (2007–2009), komuna është bashkëqeverisur nga dy partitë më të mëdha LDK-PDK. Kjo bashkëqeverisje u shtri si në Kuvendin Komunal ashtu edhe në ekzekutiv, ku dikasteret kryesor u udhëhiqen nga PDK. Kjo ka ndryshuar rrënjësisht në mandatin e dytë të Isa Mustafës, ku ekzekutivi përbehet krejtësisht nga njerëz të emëruar nga kryetari Isa Mustafa dhe LDK. Po ashtu në Kuvend LDK e ka shumicën absolute të vendeve, përkatësisht 27 nga gjithsej 51 ulëse sa ka Kuvendi Komunal i Prishtinës. Partia e dytë me e madhe në Kuvend të Prishtinës është AKR (Aleanca për Kosovën e Re) e cila ka 8 vende, e pasuar nga PDK me 6 vende.

Që nga pas lufta është besuar që Prishtina përbën $\frac{1}{4}$ e popullsisë së përgjithshme të vendit, përkatësisht është supozuar që në Komunë të Prishtinës jetojnë afro gjysmë milioni banor. Këto shifra kanë rezultuar të fryra, nëse shikohet vlerësimi preliminar i numrit të banorëve që është bërë në regjistrimin e popullsisë në vitin 2011 nga Agjencia e Statistikave të Kosovës. Sipas ESK, Prishtina i ka 198.250 banorë. Udhëheqësit e Komunës së Prishtinës shifrat e prezantuara nga ana e ESK i kanë vlerësuar si jo reale, por zyrtarisht nuk është kontestuar dhe kundërshtuar regjistrimi i popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave. Numri prej 198.250 banorësh është dyfish më i vogël se sa që është menduar se ka Prishtina banorë, pasi që Komisioni i Granteve për Komuna i Ministrisë së Financave i ka ndarë Prishtinës grant për 388 mijë banorë. Përgjegjësit e Qeverise se Kosovës kanë paralajmëruar se qe nga fillimi i vitit 2013 do t'i ndajnë grantet për komuna ne bazë të regjistrimit të fundit të popullsisë dhe në këtë drejtim Prishtina llogaritet që do t'i humb deri në 10 milionë euro nga 39 milionë sa i janë ndarë deri tani nga niveli qendror.

Raportet në mes Komunës së Prishtinës, e cila udhëhiqet nga LDK dhe Qeverisë së Kosovës e prirë nga PDK në shumë raste kanë qenë të mjegullta. Udhëheqësit e Prishtinës në vazhdimësi kanë aluduar që Qeveria e Kosovës po e diskriminon dhe po e përjashton Prishtinën qëllimisht nga investimet kapitale, pohime këto që janë kundërshtuar nga ana e zyrtarëve të Qeverisë. Përgjithësisht raportet mes këtyre dy niveleve të qeverisjes janë karakterizuar me acarime, por edhe me

pajtime të përbashkëta në sfera e projekte të ndryshme. Instituti GAP ka evidentuar disa raste te mos pajtimeve mes këtyre dy niveleve të qeverisjes, ashtu siç janë hasur projekte të përbashkëta.

Ecuria e zhvillimeve të përgjithshme në kryeqytet që nga fillimi i mandatit të dytë të kryetarit aktual të Prishtinës nga këndvështrimi i Institutit GAP është matur nga numri i premtimeve të dhëna dhe shkalla e realizimit të tyre. Kësisoj gjatë fushatës zgjedhore 2009, kandidati për kryetar komune për mandat të dytë, tani kryetari i Komunës z.Isa Mustafa, elektoratit të tij iu prezantua me një plan qeverisës për periudhën katërvjeçare i quajtur “Përmbledhje e Programit për Qeverisjen e Prishtinës 2010-2013”, në të cilin përshkruheshin hapat konkret të kryetarit të komunës në rast të zgjedhjes së tij për kryetar. Bazuar në këtë program qeverisës dhe pas monitorimit të të gjitha premtimeve të dala nga fushata zgjedhore, Instituti GAP dhe BIRN, në 2010 i kanë shkruar letër të hapur Kryetarit të Komunës së Prishtinës z.Isa Mustafa të cilit ia përkujtuan edhe një herë premtimet e dhëna, duke kërkuar njëkohësisht realizueshmërinë e tyre. Në bazë të hulumtimit të GAP del se pas dy viteve të qeverisjes në komunën e Prishtinës, apo gjysmën e mandatit qeverisës, 48 premtime apo 58.5% e premtimeve të dhëna nuk kanë filluar fare së realizuari. Vetëm katër premtime mund të konsiderohen si të përfunduara të tërësi, gjersa pjesa tjetër (36% e premtimeve) janë në faza të ndryshme të realizimit dhe mund të realizohen deri në përfundim të mandatit aktual qeverisës.

Problemet me të cilat aktualisht përballet kryeqytetit mbetin evidente. GAP ka evidentuar dhe numëruar problemet, mangësitë dhe vështirësitë duke bërë një lidhshmëri pasqyrimesh nga fusha e investimeve kapitale, mënyra e shpenzimit të parëse publike, funksionimi i administratës, efikasiteti i Kuvendit të Prishtinës dhe të vetë ekzekutivit dhe po ashtu janë vlerësuar ndaras të gjitha premtimet e dhëna dhe shkalla e realizimit të tyre.

2. Pesë problemet më të mëdha të identifikuara gjatë fushatës elektorale 2009

Gjatë fushatës elektorale të 2009, Instituti GAP kishte identifikuar pesë probleme kryesore¹ të cilat ishin ngritur si shqetësime gjatë kontakteve me qytetarë. Pesë problemet më të mëdha në fund të 2009 ishin:

1. Komunikacioni
2. Mungesa e ujit
3. Mirëmbajtja e banesave kolektive
4. Mungesa e hapësirave të gjelbëruara
5. Pamja e shëmtuar e qytetit

Kandidatët për Kryetarë të Komunës së Prishtinës, duke përfshirë edhe kryetarin aktual z.Mustafa, gjatë debateve televizive “Zgjedhjet Lokale 2009”², kishin dhënë opsionet e tyre se si do të zgjidhin këto pesë probleme në mandatin e tyre katër vjeçar në rast se zgjidhen kryetar komune.

Më poshtë do të përshkruajmë atë se çfarë ka ndryshuar në mes periudhës dhjetor 2009 – prill 2012, sa i përket zgjidhjes së pesë problemeve kryesore të identifikuara nga qytetarët në fund të 2009.

2.1. Komunikacioni

Autoritetet e kryeqytetit edhe për kundër disa projekteve dhe investimeve në krijimin dhe ndërtimin e rrugëve të reja nuk kanë arritur deri tani që të zgjidhin problemet në komunikacion e cila konsiston në dy aspekte kryesore, në njërën anë tollovitë dhe kolonat e gjata në komunikacion, si dhe në anën tjetër mungesa e parkingjeve adekuate për vetura.

Asnjë investim nuk është bërë në tri segmente kryesore ku është konstatuar mbingarkesa e komunikacionit, përkatësisht në rrugën për në “Veternik”, përgjatë rrugës “Agim Ramadani”, si dhe përgjatë rrugës “Eqrem Qabej”. Ndërhyrjet e komunës në zgjerimin dhe rregullimin e rrugës “Vëllezërit Fazliu” në “Kodër të Trimave” i kanë evituar problemet e tollovisë në komunikacion në atë zonë dhe ngjashëm mund të thuhet edhe për rrugën “Bill Clinton” ku zgjerimi dhe rregullimi i saj e kanë evituar tollovinë në atë pjesë të kryeqytetit.

¹ Instituti GAP. Prishtina – raporti komunal. Tetor 2009. Burimi: http://institutigap.org/repository/docs/Prishtina-raporti_komunal.pdf.

² Jeta nw Kosovw, transmetuar nw Radio Televizionin Publik, Tetor 2009. Burimi: <http://www.jetanekosove.com/shikovideo/211/Alb>.

Gjendja paraqitet edhe më e keqe për sa i takon vende për parking të veturave dhe komuna në këtë drejtim nuk ka arritur të ndërmerr hapa serioz për të zgjidhur këtë problematik. I vetmi hap i komunës gjatë këtyre viteve ka qenë ofrimi i hapësirës prapa “Pallatit të Rinisë dhe Sportive” për parking të veturave e cila hapësirë është dhënë nga komuna për kompanitë private në menaxhim. Në të gjitha zonat e Prishtinës, e veçmas në qendër, trotuaret për këmbësor janë të zënë nga veturat dhe automjetet tjera, ndërsa këmbësoret detyrohen të lëvizin në shiritin e paraparë për automjete. Autoritetet e kryeqytetit para gjashtë viteve kanë dhënë hapësirën afër QKUK-së në koncesion për një kompani private e cila ka pasur për obligim që brenda dy viteve të ndërtojë parkingun për vetura me kapacitet deri në 2500 vetura, por edhe pas gjashtë viteve të nisjes së punimeve, ato nuk janë finalizuar dhe nuk ka ndonjë datë se kur mund të përfundoj.

Përveç kësaj, Komuna e Prishtinës ka dështuar t’i jap në formën e partneritetit publiko-privat ndërtimin e tri parkingjeve nëntokësore në kryeqytet në zonat që janë në qendër të qytetit. Tani procedurat për ndërtimin e tyre janë kthyer nga fillimi. Do të duhet edhe me se paku një vit e gjysmë nga tani deri në nisjen e punëve eventuale për ndërtimin e tyre.

2.2. Mungesa e ujit

Gjendja aktuale e furnizimit të qytetarëve me ujit të pijes në kryeqytet është e ngjashme me gjendjen e cila ka mbizotëruar gjatë fushatës zgjedhore 2009. Zonat e kryeqytetit “Dardania” “Qendra” “Ulpiana” “Bregu i diellit” “Sofalia” “Arbëria” ballafaqohen me reduktime të ujit të pijes, ndërsa kapaciteti i ujit përgjithësisht është i pamjaftueshëm dhe i dobët. Premtimi i dhënë në fushatën zgjedhore që gjatë vitit 2010 do të niset së ndërtuari fabrika e re e ujit për Prishtinën në fshatin Shkabaj nuk ka rezultuar i saktë, ndonëse në këtë drejtim janë finalizuar planet financiare, akoma nuk ka kompani të përzgjedhur për ndërtimin e fabrikës dhe nuk ka ndonjë datë se kur pritet të nisin punimet për ndërtimin e saj.

2.3. Mirëmbajtja e banesave kolektive

Banesat apo ndërtesat të cilat i takojnë kategorisë publike vazhdojnë të jenë në gjendje jo të mirë. Në pjesën dërrmuese të tyre ashensorët janë jo funksional, mungon ndriçimi i brendshëm, mungojnë anësorët e shkallëve për siguri, mungon mirëmbajtja e përditshme e hapësirës, dritaret e korridoreve janë përgjithësisht të thyera, mungojnë dyert e hyrjes, mungon sinjalizimi i brendshme në raste të rreziqeve, mungojnë aparaturat e ujit për fikjen eventuale të zjarrit, si dhe, në shumë raste janë hasur orët e rrymës pa mbështjellës adekuat. Asnjëra nga ndërtesat apo banesat publike nuk ka shkallë emergjente si dhe mungojnë shkallët që do të mund të shfrytëzoheshin nga personat me aftësi

të kufizuar. Edhe përkundër kësaj gjendje në terren, nëse shikohen raportet e shpenzimeve komunale vetëm në vitin e fundit (2011) atëherë vërehen shifra të larta të shpenzuara për këto qëllime. Përkatësisht në raportin e shpenzimeve vjetore të dorëzuar nga Drejtoria e Shërbimeve publike në Komunë të Prishtinës thuhet se riparimi i ashensorëve në qytet ka kushtuar 350.824 euro, por në raport nuk specifikohet se ku janë riparuar këta ashensor dhe as cila ka qenë kompania apo kompanitë punë kryerëse.

2.4. Mungesa e hapësirave të gjelbëruara

Në këtë drejtim gjendja paraqitet me e mirë, krahasuar me tri vite me herët, por akoma mbetet larg asaj që është synuar dhe që kërkohet nga ana e qytetarëve. Në disa lokalitete janë krijuar parqe dhe hapësira të gjelbëruara siç është lagjja “Dardania”, “Arbëria”, “Bregu i Diellit”, gjelbërimi dhe mirëmbajtja e tij përgjatë rrugës “Agim Ramadani” dhe disa oaza gjelbërimi në sheshin “Nëna Terezë”. Por edhe në këto hapësira hasen disa zona të lëna pas dore të cilat kanë mundur të gjelbërohen dhe kësisoj të ndikojnë pozitivisht si për qytetin ashtu edhe për banorët përgjatë këtyre zonave. E tillë është hapësira në lagjen “Dardania”, tek rruga “Lekë Dukagjini” e cila nuk është trajtuar asnjëherë në pikëpamje të gjelbërimit, ndonëse natyra e saj fillimisht është dedikuar kësaj kategorie. Ngjashëm hasen zona edhe në lagjen “Ulpiana” përkatësisht tek katedralja e vjetër e qytetit, zonë kjo e patrajtuar. Gjelbërimi në qendër të qytetit është atakuar nga ana e kafiterive të cilat kanë shfrytëzuar hapësirat e gjelbëruara para lokaleve të tyre për vënien e karrigeve dhe tavolinave. Po ashtu në disa pjesë të kryeqytetit ka pasur raste të shpeshta që mbjelljet e luleve dhe fidanëve të tjera janë tharë shkak i mos mirëmbajtjes së tyre, këto raste janë hasur në oborrin e shkollës “Nazim Gafurri” si dhe përgjatë rrugës “B”. Ndërkaq shuma që komuna shpenzon në këtë drejtim nuk është e vogël. Vetëm në vitin e fundit (2011) “Hortikulturës” i janë dedikuar mbi 600 mijë euro për këtë qëllim.

2.5. Pamja e shëmtuar e qytetit

Hulumtimet e fundi të opinionit të prishtinaseve për pamjen e qytetit kanë rezultuar me shifrën se mbi 80 % të qytetarëve në kryeqytet nuk u pëlqen pamja e qytetit.³ Për më tepër vlerësimet e mëhershme të GAP-it kanë treguar se pamja e shëmtuar e qytetit vije nga mungesa e parkingjeve, mungesa e gjelbërimit, grumbuj antenash satelitore të vendosa në banesat e qytetit, tollovote në komunikacion, mos gëlqerosja e ndërtesave publike, ndërsa si faktori me kryesor në atakimin e pamjes së qytetit janë llogaritur pamundësia e autoriteteve të Prishtinës për t’i ndaluar ndërtimet pa leje të cilat i kanë dhënë qytetit pamje

³ http://www.advocacy-center.org/Raporti-Opinion_i_qytetarëve_lidhur_me_fletushkat-e-bizneseve.pdf


jashtë kritereve urbanistike dhe e cila është vështir të përmirësohet në një të ardhme të afërm.

E vetmja sferë ku është punuar nga autoritetet lokale gjatë dy viteve të kaluara nga gjithë këta faktor atakues të pamjes së qytetit është ajo e gëlqerosjes së ndërtesave publike të cilat janë ndërtuar para viteve '90 dhe të cilat kanë qenë përgjatë rrugëve dhe vendbanimeve të qendrës së qytetit. Kësisoj gjatë 2011 janë gëlqerosur ndërtesat përgjatë rrugës së "UÇK-së", "Fehmi Agani". "Luan Haradinaj", "Rexhep Luci", "Qamil Hoxha", "Agim Ramadani", "Hajdar Dushi". Gëlqerosja e këtyre ndërtesave ka kushtuar 561 mijë euro. Një veprim i tillë i gëlqerosjes së ndërtesave publike nuk është ndërmarr edhe në lagjen "Ulpiana" si dhe përgjatë rrugës për Germi, ndërtesat e të cilëve zona kanë mbetur të pagëlqerosura. Në lagjen "Bregu i Diellit", përgjatë rrugës "Enver Maloku", pesë ndërtesa publike janë gëlqerosur me iniciativën dhe financimin e vetë banorëve që jetojnë në to, ani pse sipas tyre, disa herë radhazi ata ju kanë drejtuar Komunës së Prishtinës me kërkesën që ndërtesat e tyre të gëlqerosën, gjë e cila nuk është marr parasysh.

3. Performanca buxhetore e komunës së Prishtinës

Niveli i buxhetit komunal të Prishtinës ka shënuar rritje nga viti në vit. Kjo rritje e buxhetit ka ardhur nga dedikimet shtesë financiare në komunë nga niveli qendror, për faktin e ngritjes së pagave, transferit të kompetencave në sektorin e pyjeve si dhe në politikat sociale. Por edhe kategoria e të hyrave vetanake ka shënuar rritje to vogël nga viti në vit. Komuna e Prishtinës është një ng komunat em të hyrat më të mëdha vetanake, mirëpo ekziston hapësirë edhe më e madhe që Komuna të rrit dukshëm nivelin e të hyrave vetanake. Edhe planifikimet për tri vitet e ardhshme 2012-2014 nuk parashohin rritje të madhe të të hyrave vetanake (shih trafikonin nr.1).

Grafikoni nr.1: Të hyrat vetanake të Komunës së Prishtinës 2009-2014



Burimi: Ministria e Financave – Raporti Vjetor Financiar për 2011 dhe Tabelat e Buxhetit të Kosovës për 2012.

Problem në menaxhimin e buxhetit paraqet edhe bartja e fondeve nga viti në vit. Tani e tri vite, Komuna e Prishtinës ka bartur nga viti në vit miliona euro buxhet, shkak i pamundësive të ndryshme që ato mjete të alokohen apo të shpenzohen. Kësisoj nga viti 2010 në vitin 2011 janë bartur mbi 16.2 milion euro, ndërkaq nga viti 2011 në vitin 2012 janë bartur afërsisht 17 milionë euro apo shprehur në përqindje për të dy vitet e fundit buxheti ka mbetur i pashpenzuar në rreth 27 %. Bartja e mjeteve nuk bje ndesh me parimet ligjore, por bje ndesh me praktikat e mira të menaxhimit të parasë publike. Bartja e mjeteve nënkupton edhe bartjen e projekteve nga një vit në tjetrin dhe kësisoj krijohet një gamë e gjerë e projekteve që do të duhet realizohen dhe krejt kjo ka pasur efekte negative, ngase është manifestuar me nguti dhe huti në investime dhe me pamundësi të mbikëqyrjes efikase të punëve në terren. Mjetet e bartura nuk hynë në kategorinë e suficitit, ngase në këtë kategori hynë vetëm mjetet e dedikuara nga niveli qendror për grantin për shëndetësi dhe atë për arsim.

Udhëheqësit e Komunës së Prishtinës bartjen e afro 17 milionë eurove nga viti 2011 në atë 2012 e kanë arsyetuar me vonesat që janë paraqitur në fillim të 2011 për t'u miratuar buxheti nga Kuvendi i Kosovës i cili është aprovuar në muajin mars të 2011. Arsyetimi i zyrtarëve të Prishtinës duket i paqëndrueshëm, nëse shikohet kronologjia apo ecuria buxhetore edhe përgjatë viteve tjera. Nga viti 2010 në vitin 2011 janë bartur 16.2 milion euro, vit ky kur buxheti shtetëror është miratuar në afat të rregullt kohor.

Nga ana tjetër Kryetari i Prishtinës në vazhdimësi ka aluduar se janë pikërisht mjetet financiare ato që nuk po i mundësojnë komunës një zhvillim më të hovshëm dhe realizim të projekteve të mëdha kapitale për kryeqytetin.

Komuna nuk ka dizajnuar një plan konkret për t'i rritur të hyrat vetjake financiare. Aktualisht tri janë sferat nga ku komuna realizon më së shumti të hyra: nga lejet e ndërtimit, nga shfrytëzimi i hapësirës publike prej bizneseve dhe subjekteve tjera si dhe nga tatimi në pronë.

Lehtësia e të ndërtuarit pa leje në kryeqytet ka bërë që komuna mos të arkëtoj në nivelin e duhur të hyra vetjake nga taksat për ndërtime. E ngjashme paraqitet situata edhe për shfrytëzimin e hapësirave publike në kryeqytet, të cilat në pjesën dërrmuese të rasteve bëhet pa pasur leje komunale dhe rrjedhimisht nga kjo edhe pa ju nënshtruar tarifave komunale. Po ashtu në ato raste kur bizneset paguajnë për shfrytëzimin e hapësirës publike pagesa është trefish me e vogël se sa hapësira që shfrytëzohet nga ana e tyre.

Në strukturën e të hyrave vetjake, pjesën më të madhe e përbëjnë të hyrat nga lejet e ndërtimit 48%, të hyrat nga tatimi në pronë 20%, shfrytëzimi i sipërfaqeve publike 6.8%, participimi në arsim 6% dhe shëndetësi 1% . Të hyrat e realizuara nga lejet e ndërtimit, kanë shënuar rritje prej 5% në raport me vitin paraprak, ndonëse realizimi ka arritur në 87.8% të planifikimit.

Sipas të gjeturave të Auditorit të Përgjithshëm, Komuna e Prishtinës ka lëshime dhe zbrazëtira të shumta në ecurinë e shpenzimeve dhe menaxhimit buxhetor e financiar. Kësisoj raporti i fundit i Auditorit të Përgjithshëm konstaton se janë gjetur të dhëna të cilat flasin se autoritetet e Prishtinës kanë ndërhyrë në kontratat e lidhura për kryerjen e punëve publike, në nenet ku flitet për shumën e mjeteve që do të duhet shpenzuar dhe dedikuar kompanive private që marrin punë përmes tenderëve publik në kryeqytet. Kësisoj Auditori i Përgjithshëm përmend rastin e rregullimit të kolektorit në lagjen "Kalabria" ku transferi i parave tek kompania "Çlirimi" në vlerë prej 846.712 eurove është bërë duke ndërhyrë në pjesën e kontratës ku flitet për kushtet e pagesës dhe kësij është mundësuar transferi i parave, gjë e cila në versionin e parë të kontratës nuk ka qenë e mundur të bëhet, ngase është kërkuar përqindje e caktuar e realizimit të punëve në terren.

Auditori po ashtu ka evidentuar raste siç është ajo për ndërtimin e shkollës fillore në fshatin Hajvali ku autoritetet e Prishtinës i kanë derdhur 70% të mjeteve tek kompania private, ndonëse në kohën e derdhjes së këtyre mjeteve përqindja e realizimit të punëve ka dalë të jetë vetëm 35%. Auditori në këtë rast përmend mos gatishmërinë e zyrtarëve të komunës për t'ia afuar auditorit kontratën e kërkuar nga ana e tyre për ndërtimin e shkollës fillore në Hajvali.

Lëshime gjatë ecurisë së shpenzimeve të mjeteve publike në Komunë të Prishtinës sipas Auditorit të përgjithshëm janë hasur edhe gjatë realizimit të punimeve për zgjerimin dhe rregullimin e rrugës "Bill Clinton" ku kontrata është lidhur me vlerë prej 1.621.497 euro, përderisa mjete të zotuara në lidhje me këtë projekt kanë qenë në vlerë prej 600 mijë eurosh.

Sipas Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm (ZAP) anomalit e hasura në Komunë të Prishtinës kanë pasur të bëjnë edhe me mënyrën e përdorimit të kodeve financiare, ku për një projekt të caktuar është përdorur kodi financiar nga një projekt tjetër. Po ashtu janë hasur raste kur ka pasur pagesa të dyfishta për çështjen e njëjtë, siq është rasti i ngrohjes për shkollat "Dardania", "Faik Konica", "Ali Sokoli" dhe shkollën fillore "Hasan Prishtina", ku komuna për një muaj ka bërë dy herë pagesa të faturave për ngrohje.

Komuna e Prishtinës për dhjetë vite radhazi ka paguar faturat e ujit, deri në gusht të 2011, për shkollën fillore "Dardania" në vlerë nga 3270 euro deri në 4400 euro, përderisa për shkollat e tjera mesatarja e pagesës për faturat e ujit gjatë kësaj dekade kanë qenë nga 300 deri në 400 euro në muaj. Për gjithë këtë kohe Komuna e Prishtinës nuk e ka shqyrtuar nivelin kaq të lart të pagesës për shkollën "Dardania" dhe është dashur evidentimi i kësaj çështje në raportin e fundit të auditorit që me pastaj të vlerësohet se pse shkolla "Dardania" shpenzon aq shumë ujë dhe para. Ekipet e komunës kanë gjetur një gyp të shkollës të shpërthyer i cili në vazhdimësi ka derdhur ujë në menynë të pakontrolluar, por e cila i është faturuar shkollës. Mesatarja e shpenzimeve vjetore të parave nga komuna për ujin e shkollës "Dardania" kap shifrën e mbi 40 mijë eurove, apo mbi 400 mijë për dhjetë vite. Krejt kjo është përcjell në heshtje nga Komuna e Prishtinës dhe nuk është adresuar përgjegjësia të asnjë zyrtar komunal apo i shkollës në lidhje me këtë.

Në dy vitet e fundit Komuna ka nisur të diskutoj me qytetarët planin e buxhetit për vitin vijues duke kërkuar nga qytetarët që t'i adresojnë kërkesat dhe nevojat e tyre. Këto debate kanë pasur një shtrirje të gjerë territoriale, por numri i pjesëmarrësve në to ka qenë i vogël dhe zakonisht nga qytetarët janë adresuar shqetësime individuale dhe jo në mënyrë të organizuar si lagje. Pjesëmarrja e vogël në këto diskutime ka ardhur edhe nga shkaku që komuna nuk ka bërë një informim më të mirë dhe ftesë me të detajuar ndaj qytetarëve. Zakonisht ftesa është bërë nëpërmjet medieve të shkruara ose duke venë pankarta të vogla në shtyllat elektrike pak orë para se të zhvillohet debati.

Komuna e Prishtinës në raportet e saja vjetore (2010 -2011) nuk ka paraqitur në asnjë rast shpenzimet komunale që behën për karburante, atë të telefonave, darkave dhe drekave zyrtare, udhëtimeve zyrtare si dhe nuk ka publikuar të

dhëna në lidhje me shpenzimet që bëhen në bufën e komunës e cila akoma nuk është e privatizuar si shërbim, por punon brenda dikastereve të komunës dhe të punësuarit aty llogariten staf civil i komunës. I vetmi shpenzim që përmendet në raportin vjetor të komunës është ai për karburante për automjetet e komunës të cilat llogariten të jenë afro 70 të tilla. Por, edhe ky pasqyrim është gjysmak dhe nuk afrohet shuma e parave të shpenzuara, por shuma e litrave të shpenzuar nga komuna. Kësisoj në bazë të këtij raporti (2011) përmenden 559.591 kilometra të shënuara me vetura zyrtare, ndërsa epet shifra prej 75.852 litrave karburante të shpenzuara, pa u specifikuar shuma e parave të shpenzuara.

Por, nga hulumtimi i GAP-it ka rezultuar se shuma e mjeteve të kontraktuara nga komuna në fushën e karburanteve del të jetë shumëfish më e lartë. Kësisoj 21.10.2011 është nënshkruar kontrata për furnizimin e shkollave fillore të Prishtinës me naftë në vlerë të kontratës 1.353.153 eurove. Ndërsa me 16.12.2011 është nënshkruar kontrata tjetër e radhës për furnizim me naftë për nevojat e QKMF në vlerë të 135.165 eurove. Me datë 10.01.2012 është nënshkruar kontrata për furnizim me naftë për nevoja të komunës në vlerë prej 234.240 eurosh. Me datë 8.02.2012 është nënshkruar një kontratë për furnizim me naftë për nevojat e institucioneve para -shkollore, këtu nuk specifikohet çmimi total, por vetëm jepet shuma e litrave të mundshme për shfrytëzim, kësisoj figuron shifra prej 1.289 litrave, shifër kjo që në rast të llogaritjes me çmimin e naftës në treg rezulton me afro 1.4 milionë eurosh. Shuma totale e këtyre katër kontratave kap vlerën prej mbi 3.1 milion euro.

Në kërkesën e GAP të dërguar më 11 prill 2012 për të pasur qasje në të dhënat e detajuara për shpenzimet për karburante, telefona fiks dhe mobil, dreka zyrtare dhe vizita zyrtare jashtë vendit, Komuna ka kthyer përgjigje gjysmake duke ofruar të dhëna vetëm për shpenzimet për karburante, telefonata dhe dreka zyrtare, por duke mbajtur fshehur shpenzimet për vizita zyrtare. Në bazë të përgjigjes së Komunës del se shpenzimet e telefonisë fikse për 2011 janë 31.395,91 euro, ndërkohë që për këtë periudhë raportuese shpenzimet e telefonisë mobile janë 13.501,97 euro. Tek kodi buxhetor "dreka zyrtare", në kuadër të se cilit futen po ashtu shpenzimet që janë bërë për aktivitetet që kanë bërë Zyra e Kryetarit të Komunës, për këtë qellim janë shpenzuar: 47.590,90 euro. Pjesa dërrmuese e shpenzimeve të poshtë-cekura nuk figurojnë në raportet zyrtare të Komunës së Prishtinës të bëra gjatë 2011:

	Projektet	Shuma (Euro)
1	Mirëmbajtja e semaforëve	58.959
	1.1 Modernizimi i semaforëve të vjetër	336.812
2	Mirëmbajtja e rrugëve	
	2.1 Rrugët dimërore	280.525
	2.2 Rrugët verore	500.000
3	Automjete për fikjen e zjarrit	427.200
	3.1 Veshmbathje speciale dimërore dhe verore për zjarrfikësit	76.000
	3.2 Ndërtimi i rrethojave dhe rregullimi i oborrit të zjarrfikëseve	243.401
4	Hidrantët për furnizim me ujë dhe hapja e puseve	18.936
5	Ndërtimi i strehimores në zonën "Sofalia"	207.677
6	Renovimi dhe adoptimi i strehimoreve të qytetit	29.598
7	Eliminimi i qenve endacakë (proces i mbetur në gjysmë)	18.352
8	Furnizimi me kontejnerë dhe shporta	67.250
9	Shenjzimi horizontal dhe vertikal i rrugëve	134.990
10	Shenjzimi i rrugëve dhe vendbanimeve	30.467
11	Trajtimi i varrezave dhe memorialëve	72.237
12	Pastrimi mbeturinave të ngurta	87.500
13	Pastrimi i portave hyrëse dhe shtratit të lumenjve	38.386
	Total	255.229

4. Investimet kapitale

Përgjatë dy viteve të kaluar janë implementuar një numër i konsiderueshëm i investimeve kapitale. Projekte të cilat kanë ndikuar apo pritet të ndikojnë gjerësisht në kryeqytet është rregullimi i rrugës "B" nga lagjja e spitalit, përkatësisht rruga "Muharrem Fejza" (faza e parë) e që pritet të finalizohet në zonën e "Matit" (faza e katërt). Kjo rrugë është gjerë 35 metra dhe përmban hapësirën për biçikleta, për këmbësor, shtigjet e gjelbëruara, shtylla ndriçimi në distanca të vogla. Në këtë kategori hynë edhe rregullimi apo nisja e rregullimit të sheshit "Ibrahim Rugova" dhe sheshit "Zahir Pajaziti", si dhe ndërhyrjet që janë bërë në rrugën "Bill Clinton".

Tri probleme evidente që e karakterizojnë sferën e investimeve kapitale në kryeqytet konsistojnë në radhë të parë me cilësinë e dobët të punimeve, pastaj me dinamikën e kryerjes së punëve dhe së fundi janë raste të shpeshta në kryeqytet kur një kompani fiton tenderin publik për kryerjen e punëve, ndërsa në terren punët realizohen nga një kompani krejt tjetër. Këto janë adresuar si shqetësim edhe nga kreu i Prishtinës Isa Mustafa gjatë fjalimit të tij në shtator të vitit 2011 para këshilltarëve të Kuvendit Komunal, por sipas tij, cilësia e dobët e

punëve po vije ngase Ligji i Prokurimit Publik i obligon ata që t'i japin punë kompanisë e cila konkurren me çmimin me të lirë dhe jo kompanisë që mund t'i kryejë punët më mirë. Ndërsa dinamika e punëve përmendet si anomali në kryeqytet edhe në raportin e fundit të auditorit të përgjithshëm i cili përmend rastin e ndërtimit të një fushe sportive në lagjen "Bregu i Diellit" ku në bazë të kontratës punët është dashur të kryhen 60 ditë pas nisjes, ndërsa ato nuk janë finalizuar as pas 8 muajsh të nisjes së punëve në terren.

Për çdo vit Komuna e Prishtinës shpenzon deri në 400 mijë euro për riparimin e gropave dhe sanimin e asfaltit të dëmtuar e gjithë kjo ngjet në shumicën e rasteve në rrugët e sapo asfaltuara. Shembull për këtë është marr hapësira afër stadiumit të qytetit e cila ka nisur së dëmtuari pak javë pas finalizimit të punimeve në maj të 2011. Ngjashëm ngjet edhe me trotuaret e posa rregulluara të kryeqytetit dhe shembull për këtë shërben trotuari përgjatë rrugës "Fehmi Agani". Kryetari i Prishtinës, së bashku me udhëheqësit e tjerë të kryeqytetit, në gusht të vitit të kaluar (2011) kanë promovuar fontanenë në kryqëzimin e rrugëve mes "UÇK-së" dhe "Ilir Konushevcit", fontanë e cila ka funksionuar vetëm pesë ditë pas inaugurimit dhe që nga ajo kohë, fontana është jo funksionale.

Problematikë tjetër e hasur gjatë realizimit të projekteve kapitale në kryeqytet paraqet mos bashkëpunimi ndërmjet zyrtarëve komunalë dhe qytetarëve në ato zona ku bëhet investimi. Në asnjë rast, Komuna e Prishtinës nuk e ka praktikuar informimin paraprak të banorëve të zonave ku synohet të bëhet investimi dhe një informim i tillë po paraqitet mëse i domosdoshëm, ngase kështoj banorët do të ishin të informuar për planet e komunës, trasenë e rrugës ku është paraparë të punohet, dinamikën e realizimit, koston e paraparë dhe përfitimet e lagjes nga gjithë kjo.

Gjithnjë e me shumë po ka raste kur banorët përgjatë rrugëve ku investohet po aludojnë që komuna po ua cenon dhe gllabëron pronat private dhe krejt kjo po shkakton me muaj të tërë ndërprerjen e punimeve dhe komplikime të tjera në terren. Të tilla raste gjatë dy viteve të kaluara janë hasur në lagjen "Kalabria", në rrugën "Tutini", në rrugën "Ibrahim Fehmiu", në lagjen "Kodra e Trimave", në lagjen "Velania" përkatësisht në rrugën "Hamdi Gashi", probleme e konteste të ngjashme ka pasur edhe gjatë realizimit të fazës së dytë të rrugës "B" si dhe këto probleme janë hasur apo paraqitur edhe në fshatrat e thella të Prishtinës, përkatësisht në fshatin Dabishevc.

Komuna e Prishtinës akoma nuk ka arritur të përzgjedh një kompani private e cila do të bënte mbikëqyrjen e punimeve në terren dhe kështoj, ndonëse kjo ka qenë premtim i kreut aktual të Prishtinës të dhënë gjatë fushatës zgjedhore. Për çdo projekt të investuar në kryeqytet komuna obligohet të formojë komision të posaçëm mbikëqyrës dhe vlerësues i cili komision e bënë pranimin teknik të

punëve edhe për kundër që në vazhdimësi rrugët, trotuaret dhe objektet e ndërtuara reflektojnë dhe rezultojnë me mungesë të cilësisë së punimeve dhe mungesë të cilësisë së materialit që përdorët.

Përveç kësaj në të gjitha projektet investuese në vlerën mbi 350 mijë euro, komuna dhe kompanitë që marrin punë përmes tenderëve publik nënshkruajnë të ashtuquajturën 'klauzolë shtesë' e cila obligon kompanitë që në një afat prej 1 deri në 3 vite dëmet e paraqitura apo të shkaktuar në terren riparohen dhe sanohen nga vetë kompania punë kryerëse. Kjo në praktikë nuk aplikohet. Rast për këtë është marr kolektori dhe asfalti i shtruar mbi kolektor mbi lumin "Prishtevka", në lagjen "Gollapi", ku tre muaj pas përfundimit të punimeve janë paraqitur deformime të ndryshme dhe serioze të cilat kanë mbetur të tilla sot e kësaj dite, edhe përkundër që në kontratën e kompanisë punë kryerëse "Çlirimi" saktësohet që në një afat prej 2 vitesh të gjitha dëmet dhe deformimet që paraqiten do të sanohen nga vetë punëkryesi.

Problematikë tjetër e hasur gjatë realizimit të investimeve kapitale në kryeqytet paraqitet marrja nga një kompani private e tri apo me shumë punëve për t'i kryer, ndërsa kapacitetet e saj nuk e mundësojnë një gjë të tillë. Kjo e shtynë kompaninë që t'i nis punimet, por të mos tregohet serioze në kryerjen e tyre sipas afatit dhe dinamikës së paraparë. Kjo është vlerësuar të ndikojë edhe në cilësinë e përgjithshme të punimeve.

Projektet më të mëdha të realizuara gjatë 2010 - 2011 në kryeqytet në sferën e infrastrukturës llogariten:


Investimi kapital	Shuma (Euro)
Rindërtimi dhe rregullimi i rrugëve "UÇK" e "Fehmi Agani"	466.537
Ndërtimi i rrugës "Tumori"	425.187
Rindërtimi i rrugëve "Ismet Asllani", "Vëllezërit Maqastena", "Ismet Raci" dhe disa rrugëve në lagjet "Arbëria" dhe "Çamëria"	496.075
Rindërtimi i krahëve të rrugës në lagjet "Sheshi i Arbrit", "Tabet e Llapashticës" dhe disa rrugëve në lagjen "Kodra e Trimave"	349.524
Rindërtimi i rrugës "Rrustem Statovci"	271.373
Rindërtimi dhe asfaltimin e rrugëve në fshatrat Hajvali, Ballaban dhe Prapashticë	259.820
Ndërtimi i rrugës "B" (faza e dytë dhe faza e katërt)	4.024.868
Ndërtimi i rrugës "Ekrem Rexha" në lagjen "Arbëria"	771.266
Ndërtimi i nënkalimit për këmbësorë te "Xhamia e Llapit"	121.963
Ndërtimi i rrugës "Ahmet Krasniqi"	986.957
Ndërtimi i rrugës "Ibrahim Fehmiu" në lagjen "Kodra e Trimave"	939.190

Asfaltimi i rrugëve në fshatrat Tenezhdoll, Vranidoll dhe Bardhosh	343.264
Ndërtimi i rrugës "Qemail Stafa"	870.000
Ndërtimi i rrugës "Enver Maloku"	1.368.617
Ndërtimi i kolektorit atmosferik mbi lumin "Prishtina" në lagjen "Kalabria"	3.045.674

Disa nga investimet (planet) më të rëndësishme kapitale për 2012 veçojmë:

- Ndërtimi i sheshit "Ibrahim Rugova" dhe "Zahir Pajaziti";
- Ndërtimi i fabrikës së ujit në Shkabaj;
- Sistemi i kogjenerimit të ngrohjes në "Termokos";
- Hartimi i planeve rregulluese dhe rivedimi i planeve rregullative;
- Ndërtimi i institucionit parashkollor në "Kodra e Trimave";
- Ndërtimi dhe finalizimi i rrugës "Ibrahim Fehmiu"
- Ndërtimi i shkollës fillore "A.Kelmendi" - Barilevë;
- Ndërtimi i shkollës së mesme të muzikës "Prenk Jakova";
- Ndërtimi i pishinës së mbyllur;
- Hamami i Madh i Prishtinës - faza përfundimtare;
- Ndërtimi i institucioneve shëndetësore

Në përgjithësi në vitin 2012 parashihet të shpenzohen mbi 32.3 milion euro për investime kapitale. Siç mund të shihet edhe nga grafikoni nr.2, pjesa më e madhe e investimeve kapitale do të destinohet për ndërtimin e rrugëve dhe hapësirave publike



5. Arsimi

Para nisjes së mandatit të dytë nga kryetari aktual Isa Mustafa sistemi arsimor në vend është përballur me katër probleme kryesore:

1. Puna e shkollave në tri dhe katër ndërrime;
2. Gjendja jo e mirë e infrastrukturës shkollore;
3. Numri i madh i nxënësve për paralele në shkollat e mesme;
4. Mungesa e laboratorëve dhe hapësirave për mësim praktik;

Dy prej këtyre problemeve tani me janë evituar, ndërsa dy tjera mbesin akoma problem dhe do të duhet të ishin prioritet për vitet në vazhdim. Kësisoj në 2009 shumë shkolla të Prishtinës kanë punuar në tri ose edhe në katër ndërrime. Ky problem është evituar në Komunën e Prishtinës dhe tani të gjitha shkollat punojnë në vetëm dy ndërrime. Po ashtu në vitin 2009 pjesa dërrmuese e shkollave në kryeqytet kanë qenë në gjendje të keqe infrastrukturore dhe në këtë drejtim përgjithësisht është punuar duke shënuar kësijoj edhe një minimum të standardit të kërkuar arsimor. Problemet të cilët aktualisht hasën në sistemin arsimor në kryeqytet janë ato në shkollat e mesme, përkatësisht me numrin e madh të nxënësve në to që në shumicën e rasteve ky numër është afërsisht 40 nxënës për një klasë dhe po ashtu problem në vete paraqet mungesa e laboratorëve dhe hapësirave për mësim praktik, veçmas në shkollat e mesme profesionale.

Arsimi Komunal		
	Nr. i institucioneve	Nr. i nxënësve
Institucione parashkollore publike	9	1.774
Institucione parashkollore private	5	654
Shkolla fillore publike	28	35.390
Turq		161
Serbë		72
Boshnjakë		23
Shkolla të mesme publike	12	13.338
Turq		94
Boshnjakë		16
Shkolla apo kolegje private	5	2.750
Total	59	53.906

Po ashtu evidentimet zyrtare flasin se në kryeqytet ekzistojnë vetëm 5 institucione private para-shkollore apo të njohura ndryshe si çerdhe, dhe ky numër besohet të jetë tre apo katër fish me i madh, por funksionojnë të paregjistruara në organet komunale dhe rrjedhimisht nga kjo mund të kuptohet se funksionimi i tyre është jashtë kritereve dhe masave që do të duhet aplikuar për hapjen dhe funksionimin e këtyre institucioneve.

Mungesa e çerdheve është vlerësuar problem dhe mangësi evidente në kryeqytet dhe Komuna e Prishtinës nuk ka ndërtuar për gjatë këtyre dy viteve asnjë çerdhe publike, edhe pse pesë herë radhazi ka shpallur tender për ndërtimin e tyre në formën e partneritetit publiko - privat, por që nuk ka pasur të interesuar për ndërtimin e këtyre institucioneve. Interesimi i prindërve për regjistrim të fëmijëve të tyre në çerdhet publike të Prishtinës është jashtëzakonisht i madh dhe në bazë të kritereve komunale për të aplikuar për regjistrim të fëmijëve kanë të drejtë vetëm prindërit të cilët janë të punësuar dhe nga kjo shihet se institucioni publik nuk e ka të mundur të ofrojë shërbim për të gjithë të interesuarit, praktik kjo që do të duhet të mënjanohet si formë e menaxhimit. Nevojën për shtimin e numrit të çerdheve në kryeqytet dhe domosdoshmërinë e mbikëqyrjes së tyre më efikase e ka potencuar edhe Komisioni Evropian përmes raportit vjetor të progresit për Kosovën në tetor të vitit 2010.

Tronditëse në sferën e arsimit në Komunë të Prishtinës ka paraqitur edhe rasti i vrazës së Drejtorit të Arsimit Remzi Salihu, i vrarë në zyrën e tij në objektin në lagjen "Arbëria", rast ky i ndodhur në tetor të vitit 2011. Dorasi, për një kohë ka shërbyer si mësimdhënës i lëndës së biologjisë në shkollën fillore në fshatin Dabishevc të Prishtinës. Motivet e këtij rasti janë aluduar të vijnë si rezultat që dorasi për një kohë nuk ka arritur të punësohet në ndonjë shkollë të kryeqytetit, ndërsa në fshatin Dabishevc ku ka qenë duke shërbyer si mësimdhënës ka aplikuar për pozitën e drejtorit të kësaj shkolle, aplikim ky i cili ka rezultuar me konflikt mes tij dhe drejtorit i cili ka qenë duke shërbyer në atë shkollë. Drejtori i cili ka qenë duke ushtruar detyrën në shkollën e Dabishevcit ka pasur të kryer në atë kohë vetëm shkollën e lartë, ndërsa dorasi është thirrur në titullin master. Rasti tronditës i ndodhur, është përcjell me mungesë në Prishtinë të udhëheqësve kryesor të komunës, të cilët një ditë parë kanë udhëtuar për vizitë zyrtare në SHBA.

6. Shëndetësia

Investimet kapitale të përfunduara apo të nisura gjatë dy viteve të kaluara në sferën e shëndetësisë kapin shifrën e afro 3 milionë eurove. Ka filluar ndërtimi i objektit të QMF IV, me lokacion në rrugën “Bajram Bahtiri”, objekti ka një sipërfaqe prej rreth 1.220 m². Shërbimet shëndetësore që janë paraparë të ofrohen konsistojnë në mjekësi familjare, pediatrike, stomatologjike, të vaksinimit, si dhe për herë të parë në këtë pjesë të qytetit do të afrohet edhe shërbimet e rentgenologjisë.

Janë përmbyllur punët rreth ndërtimit të rrethojës dhe rregullimit të oborrit në QMF në lagjen “Velania”, e cila prej muajit qershor 2011 ka filluar të ofrojë shërbime shëndetësore. Është blerë një aparat i rentgenit për nevojat e QMF V, në lagjen “Dardania”. Në përfundim e sipër është rregullimi/ndërtimi i meskatit të QMF në lagjen “Arbëria”. Kanë përfunduar të gjitha procedurat dhe është nënshkruar kontrata për blerjen e 2 automjeteve-kombi për bartjen e pacientëve në hemodializë. Është blerë një autoambulancë me pajisje mjekësore për nevojat e QMU, dhe është aktivizuar shërbimi emergjent në QMF në lagjen “Kodra e Trimave”. Kanë përfunduar punët për rrethojën e oborrit të QMF në lagjen “Mati-1”. Ka përfunduar renovimi i hapësirave të QKMF si salla e trajnimeve dhe renovimi i katit të parë të QKMF e cila tashmë edhe është funksionalizuar. Mjekësia e Punës në QKMF; janë realizuar edhe renovime dhe sanime në Ambulancën në fshatin Bardhosh, Qendrën e Mjekësisë Urgjente në Prishtinë, në QMF V në lagjen “Dardania”. Janë blerë pajisje mjekësore për nevojat e QKMF dhe QMU, si aparate laboratorike – biokimike, hematologjike, pajisje për nevojat e stomatologjisë, karrige stomatologjike.

Numri prej 136 mjekeve në Komunë të Prishtinës vlerësohet i vogël, në bazë të numrit të popullsisë dhe shifrës së shërbimeve në Komunë të Prishtinës do të duhet të ishin të angazhuar 250 mjekë familjarë dhe rreth 450 infermierë.


Shëndetësia komunale	Nr.
Mjekë	135
Specialistë të mjekësisë familjare	100
Mjekë të përgjithshëm	35
Specialistë të lëmive tjera	63
Pediatër	19
Internist	3
Dermatovenerolog	8
Gjinekolog	8
Spec. të mjekësisë së punës	9
Biokimist	3
Radiolog	3
Pneumoftizilog	4
Epidemolog	1
Specialist i higjienës	1
Reumatolog	1
Oftamolog	1
Sociolog	1
Staf me kualifikim të mesëm shëndetësor	360
Stomatolog	47
Asistent/teknik i stomatologjisë	60
(Qendra e Mjekësisë Urgjente) - Mjekë	21
Specialistë të urgjencës	2
Internist	2
Specialistë të mjekësisë familjare	6
Mjekë të përgjithshëm	11
Infermierë	38

Edhe për kundër këtyre përpjekjeve dhe investimeve, problemet me evidente në shëndetësinë e kryeqytetit lidhen me mungesën e barnave dhe mjeteve esenciale për ofrimin e shërbimeve, që në pjesën dërrmuese të rasteve vetë pacientet duhet të dalin dhe t'i blejnë ato.


Problematikë në vetë paraqet shuma e lartë e karburanteve dhe rrymës që shpenzohet në këto qendra shëndetësore në Prishtinë. Vetëm për Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare në Prishtinë për një vit kontraktohen mbi 135 mijë euro karburante, shifër kjo për 50 mijë euro më shumë se sa shpenzimet zyrtare që i bënë Komuna e Prishtinës për të njëjtën fushë gjatë një viti.

7. Administrata komunale


Administrata komunale e Prishtinës përbëhet prej 11 drejtorive dhe një staf të të punësuarve prej 719 shërbyesve civil.




Përgatitja shkollore e shërbyesve civil



Përkatësia etnike e shërbyesve civil



Struktura gjinore



Gjatë vitit 2011 katër shërbyesve civil iu është ndërpre kontrata me arsyetimin e mos efikasitetit në punë. 13 shërbyes civil janë pensionuar, tre shërbyes civil kanë vdekur, ndërsa marrëdhënie pune në Komunë të Prishtinës gjatë këtij viti kanë krijuar 29 persona.

Pranimi i këtyre personave në punë kryesisht është bërë pa pasur konkurs të hapur publik, përkatësisht gjatë gjithë vitit vetëm për 12 pozita të shërbyesve civil është hapur konkursi, ndonëse marrëdhënie të punës kanë krijuar 29 persona, gjë kjo e cila rezulton se 17 persona janë pranuar në punë pa u shpallur konkursi për pranim e tyre. Zakonisht Komuna e Prishtinës konkurset për punë i shpall nga ato drejtori të cilat kërkohet staf i specializuar, siç është rasti me konkurset vjetore të shpallura nga Drejtoria e Arsimit për pranimin në punë të stafit mësimdhënës në shkollat fillore dhe atyre të mesme, por kjo kategori e të punësuarve nuk bije në domenin e shërbyesve civil të komunës. Po ashtu konkurset shpallen për të kërkuar arkitekt, përfaqësues juridik, inxhinierë të komunikacionit e kështu me radhë. Janë të pakta dhe të radha konkurset për

pranimin e stafit të përgjithshëm administrativ dhe në këtë fushë bënë pjesë edhe numri me i madh i të pranuarve në punë në Komunë të Prishtinës.

Gjatë një dite në Komunë të Prishtinës vlerësohet se shërbime kërkojmë nga 350-400 qytetarë. Cilësia dhe shpejtësia e shërbimeve vlerësohet relativisht e mirë. Problem paraqesin shërbimet që ofrohen në objektin e ri të komunës në lagjen "Arbëria" ku para sporteleve të Drejtorisë së Pronës dhe atë të Kadastrit vërehet një numër relativisht i madh i qytetarëve para sporteleve dhe sipas tyre ka raste kur gjatë një dite nuk arrihet të dorëzohet dokumentacioni përkatës në këto drejtori.

Është inkurajuese hapi që ka ndërmarr komuna gjatë 2011 në objektin e vjetër të komunës, ku kati i parë është ri-modeluar në tërësi duke i hapur zyrat dhe modernizuar ato, përkatësisht është larguar modeli i zyrave të betonuara dhe të mbyllura dhe është aplikuar modeli i zyrave të gjamit, ku zyrtarët dhe qytetarët mund të shohin pa pengesë njëri tjetrin. Përgjatë gjithë kësaj hapësire ekzistojnë tabela orientuese për qytetarët të cilat varësisht japin shpjegimet e duhura për numrin e zyrave dhe për shërbimet që afrohen në to. Komuna gjithsej numëron 44 zyra të tilla ku afrohen shërbime qytetarëve, pa llogaritur këtu edhe bashkësitë lokale të cilat afrojnë shërbime të specifikuar dhe të kufizuara për qytetarët.

Nëse krahasojmë strukturën e të punësuarve në Komunë të Prishtinës para nisjes së mandatit të dytë nga Kryetarit aktual atëherë do të shohim se gjatë 2009 në komunë kanë qenë gjithsej 699 të punësuar nga ta 172 me fakultet. Ndërsa në 2012 numri i atyre me fakultet ka shënuar rritje prej 58 personave, përkatësisht tani llogaritet që 230 shërbyes civil janë me fakultet, rënie ka shënuar numri i stafit civil me shkollim fillor, përkatësisht gjatë 2009 numri në këtë kategori ka qenë 32, ndërsa në 2012 është 19. Rënie ka shënuar edhe numri i shërbyesve civil me shkollim të lartë, përkatësisht gjatë 2009, ky numër ka qenë 44, tani është 39. Ndërsa si në vitin 2009 ashtu edhe në atë 2012 numri me i madh i të punësuarve e përbejnë shërbyesit civil me shkollë të mesme, gjatë 2009 ky numër ka qenë 451, ndërsa tani është 431. Gjatë 2009 struktura gjinore e të punësuarve ka qenë 492 meshkuj dhe 207 femra, në 2012, 482 janë meshkuj, ndërsa 237 janë femra.

Karakteristikë e cila e ka përcjell gjatë këtyre dy viteve administratën komunale të Prishtinës ka qenë numri relativisht i madh i drejtorëve të drejtorive të cilat janë udhëhequr nga ushtruesit e detyrës së drejtorëve dhe po ashtu një drejtor ka udhëhequr paralelisht me dy drejtori apo dy sektorë te ndryshme. Gjatë vitit 2011 në pjesën me të madhe të kohës, Drejtoria e Arsimit, Drejtoria e Inspektionit, Drejtoria e Urbanizimit dhe Drejtoria e Administratës janë udhëhequr nga ushtrues të detyrës edhe me gjatë së gjashtë muaj sa lejojnë

normat ligjore. Aktualisht Drejtoria e Urbanizimit akoma udhëhiqet nga ushtrues të detyrës së drejtorit.

Drejtori i administratës Halim Halimi për katër muaj ka vazhduar punuar si Drejtor i Administratës dhe njëherazi është caktuar ushtrues detyre i Drejtorit të Arsimit. Edon Miftari është caktuar tani për të udhëhequr Drejtorin e Administratës, ndërsa Halim Halimi është fuqizuar si Drejtor i Arsimit. Muhamet Gashi i cili ka qenë Drejtor për Marrëdhënie me Publikun për 9 muaj ka ushtruar edhe detyrën e Drejtorit të Inspektionit. Në fund të shkurtit të 2012 nuk i është vazhduar kontrata për drejtor të marrëdhënieve me publikun, është fuqizuar si drejtor i drejtorisë së inspektionit.

Komuna ka nisur modifikimin e statutit të saj dhe kësaj është paralajmëruar krijimi edhe i dy drejtorive të reja nga 11 sa janë aktualisht duke e ngritur numrin në 13. Drejtoria e Urbanizimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, pritet të ndahet në dysh duke mbetur vetëm Drejtoria e Urbanizimit dhe duke u krijuar edhe Drejtoria e Planifikimit. Po ashtu do të ndahet edhe Drejtoria e Financave dhe e Pronës, duke mbetur vetëm Drejtoria e Financave dhe Drejtoria e Pronës.

8. Transparenca

Transparenca në Komunë të Prishtinës përgjithësisht mund të vlerësohet si fushë ku është shënuar progres në krahasim me vitet paraprake, por akoma janë identifikuar disa të gjetura të cilat paraqesin pengesë drejtë arritjes së një shkalle të duhur të transparencës së punës së zyrtarëve komunal të Prishtinës kundruall mediave dhe opinionit në përgjithësi. Zyra për marrëdhënie me publikun tash e disa vite funksionon me vetëm një të punësuar i cili së fundmi ka qenë i emëruar edhe ushtrues detyre i drejtorit të Drejtorisë së Inspektionit. Ai për 9 muaj ka ushtruar të dyja funksionet, duke ndikuar kësaj në uljen e seriozitetit dhe shpejtësisë për të ju kthyer përgjigje gazetarëve dhe shoqërisë civile të cilët kanë adresuar pyetje në lidhje me zhvillimet e ndryshme në kryeqytet. Së fundmi në fund të muajit shkurt të 2012 Kryetari Isa Mustafa me vendim nuk i ka vazhduar kontratën e punës në pozitën e shefit për marrëdhënie me publikun Muhamet Gashit dhe në vend të tij e ka emëruar zëdhënës të komunës Asdren Osajn, i cili deri në atë kohë ka shërbyer në kabinetin e Kryetarit në cilësinë e këshilltarit politik.

Asociacioni i Gazetarëve Profesionit të Kosovës (AGPK) në gjysmën e dytë të vitit 2011 ka reaguar dhe kërkuar nga Komuna e Prishtinës që të ju përgjigjet gazetarëve në pyetjet e adresuara në këtë institucion. Kjo ka ardhur ngase vetë komuniteti i gazetarëve të cilët përcjellin zhvillimet në kryeqytet duke e pasur të pamundur shumë herë që të sigurojnë përgjigje nga zyrtarët komunal për

projektet dhe çështjet me interes të përgjithshëm, kanë kërkuar demaskimin dhe neutralizimin e një qasje të tillë zyrtare nga ana e Komunës së Prishtinës dhe forma e vetme për këtë është gjetur reagimi përmes AGPK-së. Komuna e Prishtinës nuk ju ka përgjigjur asnjëherë reagimit të AGPK-së.

Udhëheqësit e Prishtinës përgjithësisht kanë preferuar që mënyra e komunikimit mes komunës dhe palëve apo subjekteve të jashtme të jetë forma e centralizuar, përkatësisht që të gjitha informatat të jepen vetëm përmes Zyrës për Marrëdhënie me Publikun, por jo edhe që drejtorët e drejtorive të flasin drejtpërdrejt për çështjet të cilat i mbulojnë. Përgjithësisht komuniteti i gazetarëve në kryeqytet vlerëson që drejtorët e drejtorive në Komunë të Prishtinës hezitojnë dhe refuzojnë të flasin me media për zhvillimet e ndryshme dhe janë të shpeshta rastet kur vetë drejtorët e drejtorive kërkojnë nga gazetarët që fillimisht të drejtohen në Zyrën për Marrëdhënie me Publikun dhe më pastaj tek ta.

Vlerësuar nga prizmi i hapësirës që nxënë Komuna e Prishtinës në media në krahasim me komunat e tjera, atëherë mund të vlerësohet që kryeqyteti është trefish me shumë prezent në këto media se sa komunat tjera dhe krejt kjo e bënë të domosdoshme që udhëheqësit e komunës të plotësojnë Zyrën për Marrëdhënie me Publikun me staf me të madh se sa angazhimi i vetëm një personi.

Uebfaqja zyrtare e Komunës së Prishtinës është përgjithësisht funksionale dhe mund të gjenden informacionet bazë apo elementare për komunën dhe Prishtinën. Publikohen rregullisht vendimet, rregulloret, planet rregulluese, strategjitë e ndryshme, zhvillimet ditore komunale, procesverbalet nga seancat e Kuvendit dhe po ashtu është funksionale edhe hapësira për të aplikuar në formë elektronike për marrjen e dokumenteve të gjendjes civile. Ajo që mungon në këtë faqe dhe që jepet vetëm sipërfaqësisht është sektori i prokurimit publik, ku ka jashtëzakonisht pak të dhëna, ani pse ky organ pothuajse për çdo ditë shpall tender për punë në sektorë të ndryshme në kryeqytet. Po ashtu në këtë ueb faqe figurojnë numri i drejtorive dhe zyrave duke u specifikuar edhe kompetencat që i kanë ato, por nuk specifikohet në asnjë rast aktivitetet ditore që zhvillojnë si dhe mënyra e shpenzimit të mjeteve. Mangësi mbetet edhe pasqyrimi i buxhetit, vazhdimisht në këtë ueb faqe pasqyrohet buxheti në kuptimin e shumës dhe planifikimit për një vit me herët, përkatësisht tani në 2012 mund të hasesh buxhetin e 2011, por jo edhe atë të 2012. Po ashtu nuk prezantohen raportet e detajuara të shpenzimit të parëse publike, qofshin ato raporte tremujore, gjashtëmujore apo edhe vjetore.

9. Puna e Kuvendit Komunal të Prishtinës

Gjatë një viti Kuvendi i Prishtinës mbledhet afërsisht 13 dhe në asnjë rast nuk ka rezultuar që Kuvendi i Prishtinës t'i sfidoj, bllokoj, pamundësoj apo t'i refuzoj politikat të cilat ofrohen për miratimin në Kuvend nga ana e ekzekutivit të Prishtinës. Kjo vije në radhë të parë nga arsyeja se në Kuvend numrin me të madh të këshilltarëve e ka subjekti politik LDK-ja e cila udhëheq edhe me ekzekutiv dhe po ashtu gjatë gjithë kësaj kohe për asnjë rast nuk ka pasur qëndrim të unifikuar të spektrit opozitar në Kuvend të Prishtinës. Madje në bazë të diskutimeve të hapura në Kuvend të Prishtinës shpeshherë është e pamundur të identifikohen qëndrimet e pozitës, prej asaj të opozitës. Në asnjë rast, kur rregulloret, vendimet, planet rregulluese apo raportet vjetore vihen për miratim në Kuvend, nuk është manifestuar me rezultat 10 vota kundër, ani pse spektri opozitar në këtë kuvend ka gjithsej 25 këshilltar.

Diskutimet në Kuvend janë përgjithësisht sipërfaqësore. Madje nuk janë të pakta rastet kur krejt diçka tjetër vihet në rënd të ditës dhe krejt diçka tjetër diskutohet dhe prezantohet nga ana e këshilltarëve në Kuvendin e Prishtinës.

E vetmja fushë ku asamblistët e Kuvendit të Prishtinës tregojnë fuqinë dhe ndikimin e tyre është ajo e parashtrimit të pyetjeve ndaj drejtorëve të drejtorive komunale që kanë të bëjnë me problemet, projektet dhe ngeçjet e caktuara të cilat pyetje do të duhet të merrnin përgjigje më së largu deri në mbledhjen e ardhshme të këtij Kuvendi. Përgjithësisht pyetjet e parashtruara manifestohen me marrje të përgjigjes, por janë evidentuar edhe shumë raste të tjera kur ekzekutivi heziton apo refuzon të ju përgjigjet këshilltarëve në pyetjet të caktuara të cilat ata i kanë parashtruar. Natyra e pyetjeve kryesisht ka të bëjë me atë se pse një projekt nuk është realizuar, çka ka ndodhur me ecurinë e një projekti, çka është planifikuar në këtë fushë apo në fushën tjetër dhe në asnjë rast nuk janë hasur pyetjet që kanë të bëjnë me koston e projekteve, materialin që pritet të përdoret, çështjen e punësimit në Komunë të Prishtinës e kështu me radhë.

Në asnjë rast Kuvendi i Prishtinës nuk ka marr nisma që vetë ajo të inicojë daljen e këshilltarëve në terren në mënyrë të organizuar për t'i monitoruar apo shikuar projektet komunale dhe ecurinë e punës në to. Ky veprim ndërmerret dy herë gjatë një viti nga ana e ekzekutivit komunal ku të ftuar dhe pjesëmarrës janë edhe shefat e grupeve të këshilltarëve komunal.

Kuvendi i Prishtinës përbehet edhe nga komitetet e caktuara dhe këto komitete përgjithësisht janë jo funksionale, pa ndikim, nuk raportohet asnjëherë për mbledhjen e tyre eventuale, dhe kjo besohet të vije kryesisht nga fakti që takimet në këto komitete nuk paguhen. I vetmi komitet funksional i Kuvendit të

Prishtinës është ai për Politikë e Financa (KPF) i cili i përgatitë pikat e rëndit të ditës që do të diskutohen në mbledhjen e radhës të Kuvendit Komunal të Prishtinës.

Përbërja e Kuvendit Komunal të Prishtinës:	
Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK)	27
Aleanca Kosova e Re (AKR)	8
Partia Demokratike e Kosovës (PDK)	6
Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK)	4
Lidhja Demokratike e Dardanisë (LDD)	2
Partia e Drejtësisë (PD)	2
Vetëvendosje! (VV) ⁴	1
Partia Demokratike e Turqve të Kosovës (KDTP)	1

10. Raportet e Komunës së Prishtinës me pushtetin qendror

Raportet në mes Komunës së Prishtinës, e cila udhëhiqet nga LDK-ja, dhe Qeverisë së Kosovës, e prirë nga PDK-ja, në shumë raste kanë qenë konfliktuoze. Udhëheqësit e Prishtinës në vazhdimësi kanë aluduar që Qeveria e Kosovës po e diskriminon dhe po e përjashton Prishtinën qëllimisht nga investimet, pohime këto që janë kundërshtuar nga ana e zyrtarëve të Qeverisë.

Përgjithësisht raportet mes këtyre dy niveleve të qeverisjes janë karakterizuar me acarime, por edhe me pajtime të përbashkëta në sfera e projekte të ndryshme.

Janë katër raste gjatë këtyre dy viteve kur marrëdhëniet mes komunës dhe qeverisë janë karakterizuar me tension:

- Rasti i parë dhe me acaruesi mes këtyre dy niveleve të qeverisjes ka ngjarë në janar të 2012 kur Kryeministri i Qeverisë së Kosovës kishte deklaruar se Prishtina pasqyron shembullin me të keq të qeverisjes në Evropë. Deklaratë kjo që ka ngjall reagimin e Kryetarit të Prishtinës, i cili e ka quajtur Thaçin të pa informuar dhe të pa interesuar për Prishtinën, dhe sipas tij, Thaçi për pesë vite sa është kryeministër nuk e ka vizituar as pesë minuta Komunën e Prishtinës për t'i parë problemet dhe prioritetet në kryeqytet.

⁴ Këshilltari Vetëvendosjes! fillimisht është zgjedhur anëtar i KK të Prishtinës si pjesë e Partisë Social Demokrate (PSD).

- Rasti i dytë i acarimit të raporteve në mes të Komunës së Prishtinës dhe Qeverisë së Kosovës ka ngjarë edhe në rastin e arrestimit të 6 zyrtarëve të lartë të Komunës së Prishtinës nga ana e Njësisë për Krime Ekonomike të Policisë së Kosovës gjatë 2011, arrestime këto që kreu i Prishtinës i kishte quajtur politike të ardhura nga segmentet e PDK-së të instaluar, sipas tij, në policinë e Kosovës e që kanë për qëllim ta degradojnë dhe etiketojnë Komunën e Prishtinës.
- Rasti i tretë lidhet me Projektligjin për Prishtinën i cili vazhdon të mbetet sfera ku komuna dhe qeveria vazhdojnë të kenë qëndrime të kundërta në lidhje me atë se pse ky Projektligj nuk është miratuar në Kuvend, ndonëse është hartuar që nga fillimi i muajve të parë të vitit 2009. Qeveria këtë Projektligj e ka përfshirë në strategjinë e saj legislative të vitit 2011 për t'u proceduar në Kuvend në fund të shtatorit të po atij viti, por kjo nuk ka ngjarë. Edhe në Programin Legjislativ 2012 është përfshirë Projektligji për Prishtinën për t'u proceduar në Kuvend të Kosovës.
- Rasti i katërt ka të bëjë me unazën e jashtme të Prishtinës si dhe me zgjerimin dhe ri-asfaltimin e rrugës nga Fshati Stallovë deri në Motivod. Këtë rast kreu i Prishtinës ka akuzuar Qeverinë e Kosovës që ka ndërhyrë jashtë ligjshëm në shkurt të 2012 në Ligjin e Buxhetit pas miratimit të tij në Kuvend të Kosovës duke i marrë 1.3 milionë euro nga këto projekte nga gjithsej 4.1 milionë sa kanë qenë të parapara nga niveli qendror. Kreu i Prishtinës pati paralajmëruar ankesë në të gjitha instancat duke mos përjashtuar edhe mundësinë e adresimit të kësaj çështje në Gjykatën Kushtetuese të vendit.

Ekzistojnë edhe konflikte tjera në mes nivelit komunal (Prishtinës) dhe atij qendror sa i përket: largimit të rrethojave të institucioneve publike, aprovimin e Ligjit për pensionim të parakohshëm, bashkëpunimit në mes Komunës dhe zyrtarëve policor, etj.

Por ka raste kur Komuna e Prishtinës në bashkëpunim me nivelin qendror kanë investuar në projekte të rëndësishme komunale, si:

- Ministria e Infrastrukturës së bashku me Komunën e Prishtinës kanë asfaltuar dhe zgjeruar rrugën Hajkobill - Glllogovicë. Afro 600 mijë euro janë dhënë nga Ministria e Infrastrukturës për këtë projekt.
- Ministria e Infrastrukturës ka investuar në rrugën Koliq-Dyz- vlera e investimeve afro 330 mijë euro.
- 200 mijë euro Qeveria e Kosovës i ka ndarë me kërkesë të Komunës së Prishtinës për kompensimin e dëmeve nga vërshimet që patën prekur kryeqytetin në maj të 2011, përkatësisht rreth 400 shtëpi u patën vërshuar tërësisht apo pjesërisht në lagjen "Kodra e Trimave", në lagjen e Spitalit, në fshatin Hajvali si dhe në fshatin Shkabaj. 70 mijë euro për të njëjtin qëllim i pati ndarë edhe Komuna e Prishtinës.

- 200 mijë euro i ka dhënë Qeveria e Kosovës si grant nga MAPL për gëlqerosjen e objektit të vjetër të Komunës së Prishtinës.
- Rruga për në Veternik pritjet të zgjerohet dhe pronat private të shpronësohen dhe kompensohen në bashkëfinancim mes Komunës së Prishtinës dhe Qeverisë së Kosovës.
- Më 2011 Qeveria e Kosovës ka dedikuar 30 mijë euro Drejtorisë së Shërbimeve Publike të Komunës së Prishtinës me qëllim që kjo të zgjerojë rrjetin e ndriçimit eficient në territor të kryeqytetit.
- 1 milionë euro janë ndarë Qeveria e Kosovës për t'u rregulluar kolektori mbi lumin "Prishtevka" në lagjen "Gollapi" i cili është përmyllur në vitin 2010 dhe vlera e investimeve ka qenë 1.8 milionë euro, 800 mijë euro të ndara nga Komuna e Prishtinës.
- MASHT ka investuar rreth 10 milionë euro në kryeqytet në përmirësimin dhe zgjerimin e infrastrukturës në arsim. Kësisoj projekte të investuara nga MASHT-i në Prishtinë llogariten:
 - Objekti i shkollës për edukimin special, në lagjen "Kalabria" me sipërfaqe 4.200 metra katror.
 - Rregullimi i oborrit dhe terreni sportiv në shkollën fillore "Nazim Gafurri" në lagjen "Gollapi".
 - Rregullimi i oborrit dhe terreni sportiv në shkollën fillore "Xhavit Ahmeti" në lagjen "Kolovica".
 - Rregullimi i oborrit dhe terreni sportiv në shkollën fillore "Pavarësia" në lagjen "Dardania".
 - Rregullimi i oborrit dhe terrenit sportiv në shkollën e mesme "Gjin Gazulli".
 - Rregullimi i oborrit dhe terreni sportiv në shkollën fillore "Meto Bajraktari".
 - Objekti i shkollës së mesme në lagjen "Kalabria" (pranë shkollës bujqësore), me sipërfaqe 5.850 metra katror.
 - Objekti i shkollës së mesme në lagjen "Kalabria" (te 'Trafiku Urban'), me sipërfaqe 5.850 metra katror.
 - Objekti i shkollës së mesme në lagjen Medrese - Çamëria, me sipërfaqe 5.850 metra katror.
 - Objekti i shkollës fillore të Tjegullorja e njohur ndryshe si "Shkolla Model" me sipërfaqe 6 mijë metra katror.⁵

Këto investime dhe bashkëinvestime në mes komunës dhe qeverisë nuk janë vetëm karakteristikë e Komunës së Prishtinës, por këso lloj investimesh të përbashkëta ndodhin në të gjitha komunat e Kosovës.

⁵ Në të gjitha këto raste, veçmas në ato për ndërtimin e shkollave të reja nga MASHT, Komuna e Prishtinës ka ndarë lokacionin për ndërtimin e tyre.

11. Përmbushja e premtimeve të fushatës zgjedhore 2009

Gjatë fushatës zgjedhore 2009, kandidati për kryetar komune për mandat të dytë, tani kryetari i Komunës z.Isa Mustafa, elektoratit të tij iu prezantua me një plan qeverisës për periudhën katërvjeçare i quajtur “Përmbledhje e Programit për Qeverisjen e Prishtinës 2010-2013”, në të cilin përshkrueshin hapat konkret të kryetarit të komunës në rast të zgjedhjes së tij për kryetar. Bazuar në këtë program qeverisës dhe pas monitorimit të të gjitha premtimeve të dala nga fushata zgjedhore, Instituti GAP dhe BIRN, në 2010 i kanë shkruar letër të hapur Kryetarit të Komunës së Prishtinës z.Isa Mustafa

të cilit ia përkujtuan edhe një herë premtimet e dhëna, duke kërkuar njëkohësisht realizueshmërinë e tyre.

Tabela më poshtë mat progresin e arritur në realizueshmërinë e premtimeve të dhëna në 2009. Në këtë tabelë janë përfshirë 82 premtime të dhëna. Në bazë të hulumtimit të GAP del se pas dy viteve të qeverisjes në komunën e Prishtinës, apo gjysmën e mandatit qeverisës, 48 premtime apo 58.5% e premtimeve të dhëna nuk kanë filluar fare së realizuari. Vetëm katër premtime mund të konsiderohen si të përfunduara të tërësi, gjersa pjesa tjetër (36% e premtimeve) janë në faza të ndryshme të realizimit dhe mund të përfundohen deri në përfundim të mandatit aktual qeverisës.

Premtimet 2009	Realizimi 2010-2011
Prishtina - Qendër metropolitane, që nënkupton zhvillim dhe integrim me komunat tjera, bashkëpunim ekonomik, urban, arsimor e kulturor;	Komuna e Prishtinës gjatë tri viteve të kaluara nuk ka zhvilluar asnjë takim, konferencë, organizim apo nismë ku për temë diskutimi ka qenë sqarimi dhe harmonizimi i hapave dhe masave në drejtim të krijimit të ashtuquajturës qendër metropolitane. Kjo parashihet edhe në Projektligjin për Prishtinën, por edhe gjatë hartimit të këtij ligji, por edhe diskutimi publik i tij nga komisioni përkatës i Kuvendit të Kosovës në korrik të 2010 nuk janë ftuar dhe inkuadruar në diskutim komunat fqinje të Prishtinës të cilat do të duhet të afronin mendimin dhe vlerësimin e tyre në lidhje me planifikimet e Prishtinës që së bashku me to të krijohet qendra metropolitane. Për me tepër Komuna e Prishtinës nuk e ka bërë asnjë herë krejtësisht të qartë se çka në fakt planifikohet me këtë qendër dhe cila do të jetë mënyra e vendimmarrjes administrative, kur kihet parasysh inkuadrimi i më shumë së katër komunave në këtë qendër.
Shuma e përgjithshme e investimeve kapitale gjatë	Përgjatë tri viteve 2010-2012, buxheti i Komunës së Prishtinës i zotuar për investime kapitale është sillur rreth 30 milion euro në vit. Jo të gjitha mjetet e dedikuara janë shpenzuar. Mirëpo, nëse

<p>katër viteve të ardhshme do të arrijë në vlerë prej 700 milion euro</p>	<p>llogarisim vetëm mjetet e dedikuara për investime kapitale për tri vite shuma totale e tyre kap vlerën prej 104 milion eurosh. Dukë përllogaritur edhe vitin 2013, nga buxheti i Komunës së Prishtinës për investime kapitale për periudhën 2010-2013 nuk mund të shpenzohen më shumë se 130 milion euro.</p> <p>Përveç investimeve të komunës së Prishtinës, edhe donatorët ndërkombëtarë për periudhën 2010-2012 kanë investuar një shumë prej 17.4 milion eurosh.⁶</p> <p>Investimet kapitale të nivelit qendror në Komunën e Prishtinës (shkolla, rrugë, ujëra të zeza) për çdo vit kapin vlerën prej afro 5 milion eurosh.</p> <p>Nëse llogarisim të gjitha investimet kapitale, nga buxheti i Komunës, donatorët dhe niveli qendror, shuma maksimale e investimeve kapitale në Komunën e Prishtinës për periudhën 2010-2013 nuk e kalon asesi shumën prej 150 milion eurosh.</p>
<p>Kushte për zhvillimin e bizneseve për të krijuar vende pune për të rinj dhe femra</p>	<p>Aktiviteti kryesor i Komunës së Prishtinës gjatë këtyre tri viteve në sferën e zhvillimit të biznesit ka qenë nisma për hartimin e planit për zonën e quajtur ekonomike, plan ky i cili akoma nuk është miratuar në Kuvendin Komunal. Sipas draftit të këtij plani kjo zonë përfshin një sipërfaqe prej 612 hektarë dhe shtrihet në pjesën e veriperëndimore të qytetit të Prishtinës. Zona Ekonomike në veri kufizohet me Bernicën e poshtme, në lindje me “Kodrën e Trimave”, “Kosova Filmin”, pastaj me zonën e urbanizuar “Arbëria 3”, në jug me Fushë Kosovën, në perëndim me fshatin Shkabaj. Në këtë zonë pronë komunale, janë 139.4 ha ose 23%, ndërsa pronë private 472.4 ha apo 77% dhe vetëm 30% e gjithë sipërfaqes është paraparë të lejohet për objekte të banimit, ndërsa pjesa tjetër për qëllime të biznesit.</p> <p>Përveç kësaj, Komuna e Prishtinës nuk ka pasur ndonjë nismë tjetër konkrete për t’i lehtësuar dhe fuqizuar komunitetin e biznesit në kryeqytet. Edhe në sferën e punësimit komuna nuk ka ndërmarr asnjëherë asnjë hap apo masë e cila do të inkurajonte të papunët dhe qytetarët në përgjithësi. Në raportin e këtij institucioni për vitin 2010 dhe vitin 2011 nuk përmendet asnjë shifër kur i referohet zbutjes së papunësisë, përveç se përmendet një projekt i realizuar me UNDP i cili i ka inkuadruar në</p>

⁶ Sipas Aid Management Platform. Burimi: <http://www.amp-mei.net/gis/ShowRegionReport.do?regLocId=6119>.

	<p>një projekt punësimi rreth 30 të rijnë për një kohëzgjatje 6 mujore me pagë 120 euro në muaj. Ndërsa sipas shifrave zyrtare të nxjerra nga MPMS vetëm në Komunë të Prishtinës familje nën asistencë sociale janë 3202 familje, ndërsa numri i të papunëve në regjion të Prishtinës kap shifrën e 44.6 %, prej tyre mbi 4 mijë me përgatitje arsimore universitare. Situatë e ngjashme është edhe trajtimi i femrës. Nuk ka pasur ndonjë aktivitet, projekt apo nismë e cila do të veçohet në këtë drejtim.</p>
<p>Shërbime efikase për biznese, zona industriale, parqe dhe inkubatorë të biznesit</p>	<p>Prishtina, sipas një raporti të Bankës Botërore të prezantuar në qershor të vitit 2011, është klasifikuar e fundit në rajon për shpejtësinë dhe lehtësinë e hapjes së një biznesi. Sipas këtij raporti për t'u hapur një biznes në Prishtinë duhet 58 ditë, përderisa në Shkup kërkohen vetëm 3 ditë, Tetovë 5 ditë, Shkodër 5 ditë, Tirana dhe Vlora 5 ditë, Nikshiq 7 ditë. Komplikimet dhe ngecjet në këtë drejtim, janë manifestuar me hedhjen e përgjegjësisë nga niveli lokal në atë qendror për atë se kush i ka kompetencat për t'u marr me çështjen e biznesit. Së fundi, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë me modifikimet ligjore ka mundësuar formimin e të ashtuquajturave zyra 'one-stop-shop' ku komunat kanë detyrim t'i pranojnë aplikimet dhe t'i bëjnë vlerësimet për hapjen e bizneseve, ndërsa regjistrimi i tyre kryhet në ministrin përkatëse. Kjo është përcjell me probleme në terren, ngase Komuna e Prishtinës se fundmi ka refuzuar të nënshkruaj një memorandum me MTI ku sqarohen pozicionet dhe kompetencat e njëres dhe tjetrit institucion. Zyrtarët komunal aludojnë që kjo i zhvesh ata nga shumë kompetenca komunale. Gjatë këtyre tri viteve në kryeqytet nuk ka pasur ndonjë projekt, nismë apo investim me qëllim të krijimit të inkubatorëve të biznesit. Biznesi në kryeqytet spontanisht është vetë orientuar në zonën industriale ndërmjet Prishtinës dhe Fushë Kosovës dhe po ashtu në zonën e quajtur Veterniku.</p>
<p>Përkrahjen për bujqit për ngritje të serrave dhe ndërtim të minifermave</p>	<p>Përkrahja për bujqësi nuk ka munguar, ndonëse kjo përkrahje ka qenë simbolike. Gjatë tri viteve të kaluara në Komunën e Prishtinës, janë mbjellë afërsisht 1.310 hektarë me kultura pranverore. Në bazë të statistikave, më së shumti është mbjellë misër, 780 hektarë, ndërsa pasojnë patatet, 355 hektarë, tërshëra 68 hektarë, bimë foragjere 22 hektarë, perime 49 hektarë, fasule 19 hektarë, si dhe elb pranveror 19 hektarë. Rendimentet e grurit dhe cilësia ishin të mira. Arrinin mesatarisht 4.100 kg/ha. Rendimenti i elbit rreth 3.300 kg/ha. I tërshërës 2.900 kg/ha. Krahasuar me vitin paraprak, sipërfaqet e mbjella me drithëra të bardha kanë qenë më të vogla, mirëpo rendimentet kanë qenë më të larta për 20%. Subvencionimi i fermerëve për mbjelljen e nga 1-2 ha me misër - kanë përfituar afro 400 fermerë për tri vite sipas kategorive: Kategoria I - 193 euro (1ha misër) Kategoria II - 386 euro (2ha misër), dhe Kategoria III - 600 euro (2ha patate). Për dallim nga sektorët e tjerë, sektori për</p>

	<p>bujqësi në Komunë të Prishtinës ka arritur t'i harmonizojë me sukses hapat e saj me MBPZHR në Qeverinë e Kosovës dhe kësajsoj kanë parandaluar mundësin që një bujk apo fermer të përkraket nga të dyja institucionet në emër të subvencioneve që në të kaluarën ka pasur disa raste të tilla. Subvencionimi i Komunës së Prishtinës kundruall bujqve konsiston në fushat për mbjelljet pranverore dhe vjeshtore, furnizimi të serrave me fidanë të specave dhe domateve, trajnimet në pemëtari, furnizimi me makina mjelëse, furnizimi me fidanë të pemëve si dhe meliorimi i livadheve dhe kullosave.</p>
<p>Investime në pyllëzimin e sipërfaqeve të zhveshura dhe në mirëmbajtjen dhe ruajtjen e tyre</p>	<p>Nuk ka pasur investime dhe projekte konkrete të komunës në këtë drejtim. Prerja ilegale e pyjeve vlerësohet enorme, përderisa hapat për t'i ndëshkuar këto raste mbesin të kufizuara. Në tetor të vitit 2011 Policia e Kosovës ka arrestuar dy persona rojtar të pyjeve në fshatin Keqekoll, si dhe një polic për marrje të mitos nga prerësit ilegal të pyjeve në territorin e Prishtinës.</p>
<p>Eliminimin e ndërrimit të tretë dhe të katërt në shkolla fillore (deri në vitin 2011)</p>	<p>Kjo është realizuar në tërësi. Shkolla e fundit e cila ka qenë duke zhvilluar mësimin në ndërrimin e tretë ka qenë ajo e Hajvalisë dhe në fund të 2011 në atë lokalitet është ndërtuar shkolla e re dhe kësajsoj ndërrimi i tretë dhe katërt është mënjanuar si praktik në shkollat e Prishtinës.</p>
<p>Aplikimin e teknologjisë informatike: rrjeti kompjuterik dhe qasja në internet</p>	<p>Të gjitha shërbimet administrative dhe civile në Komunë të Prishtinës kryhen duke shfrytëzuar kompjuterët, por kjo nuk mund të thuhet edhe për bashkësitë lokale që në territorin e Prishtinës numërohen 33 të tilla. Pjesa dërrmuese e tyre nuk janë të pajisura me kompjuter dhe stafi që punon në to shfrytëzon makinat e shkrimit, në disa raste kjo vije edhe nga mos njohja e punës me kompjuter nga stafi që është i angazhuar në to. Por, nga 33 bashkësi lokale vetëm dy nga to janë të lidhura me rrjetin e internetit, përkatësisht ajo tek "Xhamia e Llapit" si dhe në "Ulpianë", të tjera nuk kanë shërbim të internetit.</p> <p>Interneti nuk është i zgjeruar dhe i instaluar as në të gjitha shkollat e Prishtinës, vetëm ato më kryesoret kanë qasje në internet. Shkollat në fshatrat e Prishtinës kanë edhe mungesë të kompjuterëve përveç që akoma vlerësohet e largët futja e tyre në sistem të internetit. Mungesa e kompjuterëve dhe e internetit vërehet edhe në QMF- të Prishtinës të cilat janë në zonën e qendrës së qytetit. Komuna e Prishtinës se fundmi ka hequr dorë nga pagesa për trajnime për të mësuar punën</p>

	<p>me kompjuter, ngase këtë nuk e ka parë të nevojshme, tani kurse mbahen për të mësuar gjuhën angleze, madje edhe për zyrtarët e lartë të këtij institucioni.</p>
<p>Salla të edukatës fizike në çdo shkollë</p>	<p>Pjesa më e madhe e shkollave janë të pajisura me salla të edukatës fizike dhe për një pjesë të shkollave janë të kontraktuara punët për ndërtimin e tyre. Në këtë drejtim, ndihmë të madhe ka dhënë edhe USAID-i i cili ka financuar apo bashkë financuar me komunën disa projekte për ndërtimin e anekseve të shkollave të cilat kanë ndikuar në krijimin e sallave të tilla. Shkollat e reja që ndërtohen në territorin e Komunës së Prishtinës përgjithësisht në projektet e tyre janë të futura edhe ndërtimi i sallave të edukatës fizike.</p> <p>Problem të kësaj natyre paraqesin shkollat në fshatrat e Prishtinës të cilat nuk kanë salla të tilla dhe nuk është investuar nga komuna për krijimin e tyre. Problematik apo mangësi në këtë drejtim paraqet fakti që ndërtimi i këtyre sallave nuk përcillet edhe me blerjen e pajisjeve të nevojshme sportive, por përgjithësisht sallat mbesin të zbrazura me disa vija horizontale dhe ku nxënësit ushtrojnë aktivitete të lira, pa pasur mjete specifike sportive apo rekreative.</p>
<p>Shkolla të mesme dhe profesionale në përputhje me kërkesat e tregut</p>	<p>Komuna e Prishtinës, te rasti i shkollave të mesme, me shumë e ka ndjekur qasjen e riparimit të tyre, se sa të ndërtimit të objekteve të reja. Vitin e kaluar ka nisur me ndërtimin e objektit të ri të shkollës “Hoxhë Kadri Prishtina”, përkatësisht Shkollës Ekonomike në Prishtinë. Përgjithësisht është investuar në ngritjen e objekteve të reja të shkollave fillore, ndërsa ndërtimi i shkollave të mesme në kryeqytet është bërë nga MASHT, ku Komuna e Prishtinës ka ndarë pronën apo lokacionin për ndërtimin e tyre, siç është rasti me ndërtimin e objektit në lokacionin e quajtur “Fusha e Pajtimit”.</p>
<p>Përfshirjen e sektorit privat, sektorit publik dhe agjencive ndërkombëtare dhe donatorëve në artikullimin e plan-programeve mësimore</p>	<p>Komuna e Prishtinës nuk ka bërë asnjë hap në këtë drejtim dhe hartimi apo artikullimi i plan-programeve mësimore është kompetencë e MASHT dhe jo e nivelit komunal. Dhënia e një pretendimi të tillë nuk mbështetet në funksionimin aktual të pushteteve dhe ndarjes së kompetencave.</p>
<p>Partneritet i ngushtë me</p>	<p>Asnjë marrëveshje apo nismë konkrete nuk ka pasur ndërmjet Komunës së Prishtinës dhe</p>

<p>Universitetin e Prishtinës, me universitetet/kolegjet private dhe institucionet shkencore</p>	<p>Universitetit Publik të Prishtinës, e as me kolegjet apo universitetet private. Për me tepër udhëheqësit e Fakulteteve në Universitetin e Prishtinës si ai Ekonomik dhe Juridik si dhe Fakulteti i Edukatës Fizike kanë kritikuar Komunën e Prishtinës që nuk po u jep leje për ndërtimin e kateve shtesë në këto fakultete. Kolegjet universitare të cilat funksionojnë në qendër të Prishtinës apo në zonat urbane shfrytëzojnë hapësirat publike për parking të veturave të tyre duke mos pasur leje përkatëse nga komuna për këtë si dhe në shumicën e rasteve duke ua pamundësuar kalimtareve ecjen e lirë në trotuare.</p>
<p>Për studentë vendorë dhe të huaj: kushte më të mira të jetesës në Prishtinë</p>	<p>Vlerësimi i zbatueshmërisë së një premtimi të këtillë është problematik. Komuna e Prishtinës nuk ka bërë asgjë të veçantë për përmirësimin e jetesës së studentëve në Prishtinë, përveq atyre investimeve të përgjithshme që janë bërë në qytet e nga të cilat mund të përfitojnë të gjitha kategoritë pa dallim.</p> <p>Rregullimi dhe modernizimi i bibliotekës së qytetit “Hyvzi Sylejmani” paraqet një hap inkurajues, ku ekzistojnë libra dhe materiale të tjera të cilat mund të shfrytëzohen edhe nga studentët.</p>
<p>Promovimin e studio-banesave si alternativë shtesë e banimit për studentë, si projekte në partneritet publiko-privat</p>	<p>Nuk ka pasur asnjë nismë nga Komuna e Prishtinës në këtë drejtim.</p>
<p>Përfundimin e Planit Zhvillimor Urban dhe Planit Zhvillimor Komunal dhe hartimi i të gjitha planeve rregulluese të qytetit të Prishtinës (deri në vitin 2011).</p>	<p>Për hartimin e Planit Zhvillimor Urban dhe Planit Zhvillimor Komunal tek në muajt e parë të vitit 2012 është hapur tenderi për përzgjedhjen e kompanive apo instituteve për projektimin dhe hartimin e tyre. Akoma këto kompani nuk janë përzgjedhur dhe akoma nuk dihet nëse do të këtë nevojë për rishpallje të tenderit në këtë drejtim. Kryeqyteti ka shënuar ngecje evidente për sa i takon hartimit dhe miratimit të planeve rregulluese. Për një vit rresht (2011) është miratuar vetëm një plan rregullues, ai për zonën e quajtur “Medrese Çamëria”. Deri tani Prishtina numëron 12 plane të tilla (Zonat “Dardania”, “Ulpiana”, “Arbëria”, “Lagjja e Muhaxhirëve”, “Dodona”, “Pejton”, “Kalabria”, “Aktash”, “Velania”, “Mati 1”, “Qendra 1” dhe “Qendra 2”) ndërkaq janë hartuar, por akoma nuk janë miratuar planet rregulluese për zonën ekonomike, për lagjen “Vellusha”. Nuk kanë nisur së hartuari planet rregulluese për lagjen “Kodra e Trimave”, lagjen “Kolovica”, për zonën e quajtur</p>

	<p>“Prishtina e Re”, për lagjen “Qëndresa” e disa lagje të tjera. Dinamika e deritanishme e punës në hartimin dhe miratimin e një plani rregullues sugjeron se do të duhet afërsisht 2 vite kohë për t’u finalizuar një plan i tillë, gjë kjo e cila e lë të nënkuptueshme që mandati i kryetarit aktual të Prishtinës deri në gjysmën e dytë të vitit 2013 nuk do ta gjejë kryeqytetin me të gjitha planet e hartuara dhe të miratuara në Kuvendin Komunal të Prishtinës. Gjatë vitit 2011 qytetarët e lagjes së “Muhaxhirëve” kanë protestuar para komunës, duke akuzuar këtë institucion se nuk po lëshon leje ndërtimi për banorët e kësaj ane, ani pse plani rregullues është i miratuar.</p>
<p>Eliminimin e burimeve për informalitete në fushën e ndërtimeve dhe legalizimi i objekteve të ndërtuara pa leje duke pasur parasysh kriteret e bazuara në aspektin e sigurisë (rrugët e evakuimit, mbrojtja nga zjarri, statika dhe dinamika e ndërtesave), aspektin social (raportet ndër fqinjësore-vizurat, insulimi, uzurpimet), dhe infrastrukturë teknike dhe sociale</p>	<p>Komuna e Prishtinës ka miratuar Rregulloren për trajtimin e ndërtimeve pa leje në korrik të vitit 2009. Një vit me vonë, ky institucion ka nisur fazën e parë të trajtimit të këtyre ndërtimeve duke kryer inqizimin satelitor të Prishtinës. Incizimi ajror ka pasur për qëllim të identifikoj në ëtrësi gjendjen në terren dhe të ndaloj ndërtimet e reja pa leje. Kjo nuk ka ndodhur. Në vazhdimësi ka pasur ndërtime pa leje në kryeqytet. Sipas të dhënave zyrtare që i posedon Drejtoria e Inspektionit e Komunës së Prishtinës vetëm <i>nga korriku i 2010 deri në fund të dhjetorit të 2011 në territor të komunës së Prishtinës kanë nisur të ndërtohen pa leje mbi 500 objekte të reja, 380 prej tyre vetëm në 2011.</i></p> <p>Trajtimi i ndërtimeve pa leje në kryeqytet ka përfshirë disa faza: Fazën e incizimit të terrenit, fazën e sensibilizimit të opinionit për t’u përfshirë në proces të legalizimeve, faza e aplikimit dhe, faza e fundit, ajo e shqyrtimit të aplikacioneve dhe mundësisë reale për legalizim të objekteve.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Faza e aplikimit ka zgjatur nga 1 shtatori deri më 31 dhjetor të vitit 2010, ku kanë aplikuar 6 mijë e 147 qytetar të Prishtinës për legalizim të objekteve të tyre. - Faza e shqyrtimit të aplikacioneve ka nisur në mars të vitit 2011 nga sektori për legalizim i cili është pjesë përbërëse e Drejtorisë së Urbanizimit. Deri në shkurt të vitit 2012 janë legalizuar 29 objekte pa leje, dy prej tyre objekte afariste apo tregtare që gjenden në Veternik. Në prag të legalizimit janë edhe afërsisht 100 objekte të tjera, ndërsa për pjesën tjetër akoma është duke u shqyrtuar dokumentacioni. <p>Rreth 2 mijë aplikime në këtë procese janë pezulluar dhe ndaj aplikantëve është kërkuar që t’i përmbushin kushtet dhe kriteret e kërkuara në të kundërtën nuk mund të përfshihen në proces të legalizimit. Kjo nismë e komunës ka qenë e diskutueshme dhe në disa raste e kontestueshme, ngase</p>

	<p>nuk ka pasur përgjigje të prerë nëse komuna ka pasur të drejtë ligjore t'i legalizoj objektet pa leje para se Kuvendi i Kosovës të miratoj një ligj përkatës në këtë drejtim. Po ashtu ka mbetur diskutim i hapur çështja se çka do të ndermirët ndaj atyre që nuk kanë aplikuar në këtë proces. Fillimisht komuna pati paraparë në Rregulloren për trajtimin e ndërtimeve pa leje edhe një kosto të lartë të cilën duhet ta paguajnë qytetarët për t'i legalizuar objektet e tyre, kosto kjo që i ka shtyrë qytetarët të hezitojnë për t'u përfshirë në këtë proces. Më vonë autoritetet e kryeqytetit kanë modifikuar koston e legalizimeve duke e zbritur atë për rreth tre fish dhe duke e lenë një kosto e cila është ekuivalente me çmimin që subjektet paguajnë në rastet e marrjes së lejes së rregullt të ndërtimit.</p> <p>Komuna e Prishtinës ka kundërshtuar Projektligjin për Ndërtimit i cili është duke u diskutuar në Kuvendin e Kosovës (prill 2012), me arsyetimin se afati i paraparë ligjor prej 30 ditësh për dhënien e pëlqimit për lejet e ndërtimit për objektet afariste është e pamundur të arrihet teknikisht.</p>
<p>Ndërtimin e mekanizmave për menaxhim urban efikas</p>	<p>Dhënia e këtij premtimi nga i kreu aktual i Prishtinës është manifestuar me mos qartësimet shtesë se cilat mund të jenë ose cilat do të jenë mekanizmat për menaxhimin urban efikas. Gjendja urbane në përgjithësi në kryeqytet është larg të dëshiruarës. Komuna e Prishtinës ka arritur t'i konsolidoj në pjesën dërrmuese të rasteve këshillat e lagjeve dhe të banesave të cilët kanë për obligim të sugjerojnë autoriteteve komunale për hapat e tyre dhe për identifikimin e mangësive dhe lëshimeve në terren. Një këshill i tillë në qendër të Prishtinës, përkatësisht përgjatë rrugës "Rexhep Luci" ndonëse i formuar, asnjëherë nuk është konsultuar dhe marr parasysh për sugjerimet dhe vërejtjet e tyre për sa i takon zhurmës nga lokalet, uzurpimit të hapësirave publike për ushtrimin e veprimtarive tregtare e hoteliere.</p>
<p>Ndërtimin dhe regjenerimin e qendrës së Prishtinës në vitin 2010 (sheshi "Ibrahim Rugova", sheshi "Adem Jashari" dhe sheshi "Zahir Pajaziti")</p>	<p>Në bazë të premtimit, këto sheshe do të duhej të ndërtoheshin në 2010.</p> <p>Realizueshmëria e këtij premtimi ka filluar me dy vite vonesë. Ndërtimi i sheshit "Ibrahim Rugova" ka filluar në mars të 2012. Punët janë kontraktuar edhe për sheshin "Zahir Pajaziti", por punët në terren akoma nuk kanë filluar, kjo pritet të bëhet gjatë muajit prill ose maj 2012. Ndërsa sheshi "Adem Jashari" akoma nuk është projektuar dhe as që ka ndonjë datë konkrete se kur mund të bëhet kjo dhe kur mund afërsisht të nisim punimet për ndërtimin e tij. Krejt kjo për faktin që në lokacionin ku është planifikuar të ndërtohet sheshi "Adem Jashari" është paraparë po ashtu edhe ndërtimi i</p>

	<p>njërit nga parkingjet nëntokësore në kryeqytet, përkatësisht tek hapësira mes Kuvendit të Kosovës dhe Komunës së Prishtinës (në vendin e quajtur “Trekëndëshi”). Pra në këtë hapësirë fillimisht pritet të punohet në hapësirën nëntokësore dhe tek pastaj mund të krijohen kushtet për nisjen e punimeve në shesh. Kjo mund të ndodhë eventalisht gjatë gjysmës së dytë të vitit 2013.</p> <p>Projektimi i sheshit “Ibrahim Rugova” dhe ai “Zahir Pajaziti” është bërë nga vetë komuna me asistencë të kompanisë “Smart Project”, pasi që 5 konkurse të shpallura radhazi nga ky institucion për projektimin e këtyre shesheve janë shpallur të pa suksesshme, ngase, sipas zyrtarëve komunal, nuk janë ofruar ide kreative dhe të përshtatshme.</p> <p>Menjëherë pas hartimit, projekti për sheshin “Ibrahim Rugova” është bërë publik nga ana e Komunës së Prishtinës dhe për tri ditë rresht palët e interesuara kanë mundur të shohin projektin dhe të japin sugjerimet eventuale. Pas kësaj është shpallur tenderi dhe është përzgjedhur fituesi për ndërtimin e sheshit në vlerë prej afro 4.3 milionë euro, 2 milionë me shumë se sa që fillimisht ishte paraparë në skemën e buxhetit komunal.</p> <p>Krejt e kundërta ka ngjarë me sheshin “Zahir Pajaziti”, autoritetet e kryeqytetit, njëherë e kanë hartuar projektin, pastaj e kanë përzgjedhur kompaninë për ndërtimin e tij, dhe dy muaj pas kësaj e kanë mbajtur vetëm një prezantim gjysme orësh të pamjes së sheshit, por jo edhe ofrim i mundësisë për qytetarët dhe ekspertët që të japin sugjerimet e tyre në lidhje me atë se si do të duhet të dukej sheshi në fjalë. Kostoja e tij është afro 4.6 milionë euro, 2.6 milionë euro me shumë se sa që fillimisht ishte paraparë në skemën e buxhetit të Komunës së Prishtinës për vitin 2012.</p>
<p>Hartimin e Planit të Konservimit për zonën historike dhe lidhja e forte e kësaj zone me qendrën e vjetër të qytetit</p>	<p>Komuna ka nisur gjatë viti 2010 hartimin e Planit Rregullues për Zonën Historike të qytetit si dhe lidhjen e tij me zonën e qytetit të vjetër. Ky plan është përcjell edhe me një konferencë të organizuar nga Komuna e Prishtinës ku historianët, arkitektet, antropologët dhe ekspert të lëmive të tjera kanë dhënë sugjerimet e tyre në lidhje me qasjen që duhet ta ndjek Komuna e Prishtinës kundruall kësaj zone. Por, nga ajo që haset në terren, shihet që kjo zonë dhe në veçanti objektet e vjetra kanë mbetur në hije nga objektet gjigante të ndërtuara përkaj tyre gjatë viteve të fundit, shumica pa leje. Pjesa dërrmuese e objekteve të vjetra nuk janë të mirëmbajtura dhe as të konservuara, gjë kjo e cila bënë që çdo ditë e më tepër ato t’i ekspozohen shkatërrimit të mëtutjeshëm.</p>

<p>Ndërtimin e qendrës së banimit dhe biznesit në lagjen “Dodona” që ka qasje në rrugën “Agim Ramadani” (përballë Kuvendit të Kosovës) në partneritet publiko-privat</p>	<p>Në 2011 ka filluar realizimi i këtij premtimi. Fillimisht janë rrënuar afro 20 objekte të ndryshme. Komuna ka treguar vetëm idenë se çka do të ndërtohet, por nuk është prezantuar edhe plani konkret se si do të duket ajo qendër, si dhe akoma mbetet e paqartë kohëzgjatja e ndërtimit të asaj qendre dhe kostoja eventuale.</p>
<p>Planifikimin urbano-arkitektonik i Qendrës së Re në kuadër të Prishtinës së Re, ndërmjet Pallatit Presidencial dhe institucioneve qeveritare</p>	<p>Në zonën e quajtur “Prishtina e Re” akoma nuk ka filluar as hartimi i planit rregullues. Ajo që mbetet evidente në atë zonë është fakti që inspektorati i ndërtimit i Komunës së Prishtinës tregohet përgjithësisht serioz dhe rigoroz në parandalimin dhe ndëshkimin e atyre që tentojnë të ndërtojnë pa leje në këtë zonë.</p>
<p>Projektimin e Sheshit Presidencial (zona qendër) dhe Sheshi i Miqësisë (Rr. “B”- Lagja e Spitalit)</p>	<p>Faza e parë e kësaj rruge është përmbyllur, punimet janë duke u zhvilluar në fazën e dytë dhe atë të katërt. Ecuria e punimeve në fazën e dytë ka pasur ngecje të konsiderueshme për shkaqe të kontesteve pronësore.</p>
<p>Parqe të reja në “Kodrën e Trimave”, në Fushën e Pajtit, në qendër të qytetit dhe te Fabrika e Tjegullave</p>	<p>Projekti për krijimin e parqeve në lagjen “Kodra e Trimave”, përkatësisht në vendin e ku me herët ka qenë deponia e qytetit, është në prag të finalizimit. Përveç hapësirave të gjelbëruara janë krijuar edhe staza sporti dhe rekreacioni. Kjo është bërë e mundur edhe falë investimit edhe nga Zyra Ndërlidhëse e Komisionit Evropian.</p> <p>Tek vendi i quajtur “Fusha e Pajtit” komuna nuk ka mundur t’i nis parqet dhe fushat e parapara si rekreative-sportive, shkaku i divergjencave mes këtij institucioni dhe kompanisë së ujësjellësit rajonal “Prishtina” në lidhje me atë se kujt i takon lokacioni në fjalë.</p> <p>Ndërsa tek zona e njohur ndryshe si “Fabrika e Tjegullave”, projekti për krijimin e parqeve është zëvendësuar me dy projekte për ndërtimin e një shkolle fillore dhe një të mesme.</p>

<p>Përkrahje për rregullimin dhe gjelbërimin e hapësirave të Universitetit të Prishtinës</p>	<p>Komuna e Prishtinës nuk ka pasur ndonjë projekt konkret për këtë hapësirë dhe nuk ka ndërmarr ndonjë nismë të kësaj natyre për hapësirën e Universitetit të Prishtinës. Disa nisma kanë ekzistuar për mbjelljen e pishave dhe trupave tjerë dekorativ, por këto kanë ardhur nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor për nder të shënimit të “Ditës së Tokës”. Këto mbjellje nuk janë mirëmbajtur qka ka rezultuar me tharjen e tyre.</p> <p>Shembull tipik i mosmirëmbajtjes së hapësirës universitare paraqet hapësira përreth shtatores së “Fehmi Aganit” përball Fakultetit Filologjik dhe mos mirëmbajtja ka ardhur ngase në rektorat përgjegjës për këtë e kanë bërë Komunën e Prishtinës, ndërsa në komunë janë arsyetuar që ajo hapësirë nuk është nën menaxhimin e tyre, por të universitetit.</p>
<p>Vazhdimin e rregullimit të shtigjeve dhe gjelbërimit të varrezave të qytetit</p>	<p>Varrezat e qytetit përgjithësisht janë mirëmbajtur mirë dhe është vërejtur një investim serioz për sa i takon rrethojave të varrezave si dhe gjelbërimit të shtigjeve përgjatë rrugës së këmbësorëve.</p>
<p>Pajisjen e parqeve, hapësirave publike dhe bulevardeve me vende të uljes dhe me infrastrukturë të duhur mikrourbane</p>	<p>Përgjithësisht kjo është arritur, në parqet e qytetit ekzistojnë ulëse të përshtatshme si dhe kontejnerë të vegjël për mbeturina dhe në pjesën dërrmuese të parqeve janë krijuar edhe këndet e fëmijëve për lojëra. Tek parqet vazhdon të jetë problemore, mungesa e ndriçimit adekuat gjatë natës, gjë kjo e cila shpesh herë i bënë ato strehë për narkomanët dhe delinkuentët.</p>
<p>Ngritjen e fontanave të përmasave dhe dizajnëve të ndryshme në parqet e qytetit dhe në sheshe, duke filluar me qendrën e qytetit</p>	<p>Prishtina gjatë tri viteve të shkuara ka ndërtuar vetëm një fontanë tek kryqëzimi i rrugës “Ilir Konushevc” dhe asaj të “UÇK-së”. <i>Kjo fontanë ka funksionuar vetëm një javë pas inaugurimit.</i> Fontana të tjera nuk janë ndërtuar, madje nuk ka ekzistuar as mirëmbajtja ndaj atyre që kanë qenë ekzistuese në kryeqytet. Fontana afër shtatores së “Nenë Terezës” në qendër të Prishtinës vazhdon të jetë jo funksionale tash e tri vite. Ngjashëm paraqitet edhe rasti i fontanës gjysmë-vertikale të shtatores së “Skënderbeut” e cila nuk është funksionale për më shumë se tetë vite.</p>
<p>Vlerësimin e ringjalljes në fragmente të dy lumenjve të mbuluar të Prishtinës si pjesë e projekteve kapitale të rrjetit të kanalizimit të</p>	<p>Në planin rregullues “Vellusha” i cili akoma nuk është miratuar në Kuvendin e Prishtinës është paraparë ndërtimi i një vije të lumit nga “Tokbashqja” deri të Muzeu i Kosovës. Rrjedha e këtij lumi është paraparë të jetë artificiale, përkatësisht uji të sigurohet nga nëntoka përmes pompave të veçanta. Ndërsa në planin “Medrese Çamëria” i cili prek një pjesë të vijës së lumit natyral “Prishtevka” është paraparë rregullimi i shtratit të lumit me gur dhe gjelbërimi përskaq tij. Të dyja</p>

<p>ujërave të zeza dhe të ujërave atmosferike në qytet</p>	<p>këto elemente janë vetëm në letër dhe nuk ka ndonjë nismë tjetër konkrete për të mundësuar zbatimin e planeve rregulluese në këto dy segmente.</p>
<p>Mbrojtjen e parkut të Gërmisë si Zonë e Veçantë dhe hartimin e Planit, nëpërmjet të cilit do të vendosen kornizat e rregullimit dhe të aktiviteteve në këtë park; (Ofrimin e mundësive për ecje, vrapim dhe aktivitete tjera që ndërlidhen me rekreimin në natyrë; Inkurajimin e turizmit rural nëpërmjet përkrahjes së sporteve formale dhe joformale të formave të ndryshme).</p>	<p>Kjo përgjithësisht është realizuar nga Komuna e Prishtinës.</p>
<p>Rigjenerimin dhe ndërtimin e infrastrukturës rrugore në të gjitha pjesët rurale të Komunës</p>	<p>Gjatë tri viteve të kaluara i është kushtuar rëndësi rregullimit dhe asfaltimit të rrugëve në zonat rurale të Prishtinës. Pothuajse në të gjitha fshatrat është punuar në përmirësimin e infrastrukturës esenciale. Gjatë 2010, shuma e buxhetit të ndarë për infrastrukturën e fshatrave ka qenë afro 1.6 milionë euro, ndërsa një vit më vonë shuma e investime në fshatra ka shënuar rritje për 200 mijë euro. Ndërsa për 2012 kemi një rënie të konsiderueshme të buxhetit për infrastrukturën e fshatrave të Prishtinës duke numëruar kështu afro 800 mijë euro në këtë drejtim.</p>
<p>Përfundimin e Rrugës Unazore Qendër</p>	<p>Në këtë projekt është punuar gjatë vitit 2009 duke e përmbyllur punët vetëm pjesërisht. Projekti është realizuar nga lagja "Xhamia e Llapit" deri tek rreth-rrrotullimi në lagjen "Arbëria" dhe nga aty ka qenë e paraparë që kjo unazë të lidhet me rreth-rrrotullimin për Fushë Kosovë. Punët kanë mbetur tek rreth-rrrotullimi i lagjes "Arbëria" dhe nga aty nuk kanë vazhduar me tutje. Krejt kjo për shkak</p>

	<p>pronësore dhe kostos së lartë të shpronësimit, por edhe për shkaqe të mos zhvendosjes së binarëve të trenave nga ana e Hekurudhave të Kosovës. Ky projekt nuk është paraparë të nis së ndërtuari as gjatë 2012. Zyrtarët komunal për këtë projekt i janë drejtuar edhe Qeverisë së Kosovës, me qëllim që kjo e fundit të lehtësojë punët e shpronësimit dhe ato të zhvendosjes së binarëve, por edhe pas kësaj nuk ka pasur ndonjë rezultat pozitiv në terren.</p>
<p>Ndërtimin unazës së jashtme në faza, sipas prioriteteve të zhvillimit të qytetit dhe orientimi i trafikut nëpërmjet kësaj rruge unazore.</p>	<p>Në këtë drejtim nuk ka pasur asnjë nismë konkrete dhe zyrtarët komunal nuk e kanë bërë të qartë nëse fare ka projekt konkret për këtë unazë.</p>
<p>Nënkalime dhe mbikalime për këmbësorë</p>	<p>Ndonëse është vlerësuar me prioritet të lartë, ndërtimi i nënkalimeve është manifestuar me ngecje evidente në terren. Janë evidentuar së paku 9 zona ku është paraqitur e domosdoshme ndërtimi i nënkalimeve apo mbikalimeve dhe deri tani janë realizuar vetëm dy të tilla. Njëra që lidh lagjen "Dardania" dhe lagjen "Pejton", tek objekti i KEK-ut, nënkalim ky i realizuar në partneritet publiko-privat, si dhe një nënkalim tjetër është ndërtuar tek vendi i quajtur "Xhamia e Llapit".</p> <p>Në mars të 2012 Komuna e Prishtinës ka zgjedhur një kompani projektuese për hartimin e planeve për tri mbikalime në formë të konstruksionit metalik. Njëri është paraparë tek vendi i quajtur shkallët e lagjes "Arbëria", i dyti tek shkolla e mesme e mjekësisë "Ali Sokoli", si dhe i fundit tek ndërmarrja "Termokos" për të kaluar rrugën magjistrale për Shkup.</p> <p>Një komision komunal i formuar për këtë qëllim, ka nxjerr në pah domosdoshmërinë që nënkalime të këtë edhe tek rruga afër Fakultetit Juridik, afër hotelit "Grand", afër Radio Kosovës, tek Banka Qendrore, te Teatri Kombëtar si dhe në rrugën "Vllezërit Fazliu" në "Kodër të Trimave". Nënkalimi i ndërtuar në vitin 2012 tek "Xhamia e Llapit" pas inaugurimit është vlerësuar i mangët, ngase nuk u mundëson qasje në të personave me aftësi të kufizuar të cilët janë të detyruar të lëvizin me karroca.</p>
<p>Rrjet të organizuar të parkingjeve në gjithë</p>	<p>Në këtë drejtim Komuna e Prishtinës nuk ka ndërmarr asnjë hap serioz për të zgjidhur njërën ndër problemet e përditshme të qytetarëve. Veturat shihen të parkuara në të gjitha zonat në trotuar duke</p>

<p>qytetin dhe garazhe përkuese</p>	<p>pamundësuar kësisoj shfrytëzimin e trotuareve nga ana e qytetarëve. Në 2010 Komuna ka lëshuar për parking të veturave hapësirën prapa Pallatit të Rinisë, por interesimi i qytetarëve për të shfrytëzuar këtë parking mbetet opsioni i fundit dhe kjo vije edhe nga arsyeja se kompania private e cila menaxhon këtë hapësirë nuk garanton për sigurinë e veturave të parkuara aty dhe madje nuk merr përgjegjësin për asnjë dem eventual të shkaktuar.</p> <p>Në shumë zona të Prishtinës, duke përfshirë edhe qendrën e qytetit, qytetarët kanë filluar t'i lëshojnë oborret e tyre për parking të veturave me pagesë, ndërsa kjo formë e veprimtarisë nuk tatimohet nga ana e Komunës së Prishtinës. Objekti i parë i nisur në 2006 për parking të veturave afër QKUK-së në partneritet publiko-privat akoma nuk është funksional. Komuna nuk është treguar rigorozë kundruall kompanisë e cila është duke ndërtuar këtë objekt dhe e cila e ka tejkaluar shumëfish afatin për ndërtimin e tij.</p> <p>Planet e Komune së Prishtinës për zgjidhjen e problemit të parkingut të veturave është paraparë të bëhet me ndërtimin e të ashtuquajturave parkingje nëntokësore. Tri të tilla janë paraparë në Prishtinë, një mes Kuvendit të Kosovës dhe Komunës së Prishtinës, mes fakultetit Filologjik dhe Katedrales dhe i fundit në mes Bankës Qendrore dhe Pallatit të Rinisë dhe Sporteve. Procedurat për ndërtimin e tyre janë shpallur të hapura në gjysmën e dytë të vitit 2010, por janë anuluar në fund të 2011, dhe tani pritet nisjes së procesit nga fillimit e që gjithë kjo parashihet të marr kohë afërsisht një vit e gjysmë.</p>
<p>Reformimin e plotë dhe rritjen e efikasitetit të shërbimit të taksive</p>	<p>Nuk është bërë asnjë hap në këtë drejtim. Janë shtuar dy kompani të reja të auto taksive të Prishtinës. Shenjat e taksive me logo të Prishtinës mund të hasen duke u shitur edhe në tregjet dhe dyqane të ndryshme dhe kjo e bënë të vështirë të evidentohet nëse të gjithë taksitë janë të regjistruar në komunë dhe po ashtu kjo e bënë të vështirë dallimin ndërmjet taksive ilegal dhe atyre të regjistruar në formë të rregullt. Akoma taksitë e Prishtinës nuk e kanë një ngjyrëshin e veturave dhe po ashtu në qarkullim vërehen shumë kombibusa dhe vetura tjera të cilët në mënyrë të paautorizuar bartin udhëtar në destinacione të ndryshme. Shpërfaqja e problemit të rreth 22 taksive të Prishtinës për të operuar në aeroportin ndërkombëtar të Prishtinës nga Komuna e Prishtinës është përcjell me heshtje dhe nuk ka pasur qoftë edhe një deklaram nga zyrtarët komunal.</p>
<p>Kufizimin e hyrjes së automjeteve në zonën e</p>	<p>Nuk ekziston asnjë kufizim për asnjë automjet për të hyrë në qytetin e Prishtinës, madje kufizime nuk ka as për kamion të tonazhit të madh si dhe ndaj auto cisternave që bartin lëndë djegëse si naftë,</p>

parë të qytetit (brenda unazës qendër)	gaz dhe materie të ngjashme.
Sistem informatikë në të gjitha Qendrat e Mjekësisë Familjare	Kjo është arritur vetëm për qendrat mjekësore në zonat e qendrës së qytetit, por jo edhe për ato në periferi dhe fshatra. Nga skema buxhetore e Drejtorisë së Shëndetësisë për 2012 në Komunë të Prishtinës nuk figuron ndonjë linjë ku parashihet zgjerimi dhe instalimi i rrjetit informatikë në këto qendra.
Pajisje dhe modernizim i QMF-ve me aparaturë të nevojshme mjekësore	Ka pasur progres të theksuar në këtë drejtim. Ka filluar ndërtimi i objektit të QMF IV, me lokacion në rrugën “Bajram Bahtiri” (te Medreseja), objekti ka një sipërfaqe prej rreth 1.220 m ² . Shërbimet shëndetësore që janë paraparë te ofrohen do të jene te natyrës se mjekësisë familjare, pediatrike, stomatologjike, vaksinimi, si dhe, për herë të parë në këtë pjesë të qytetit, shërbimet e rëntgenit. Është blerë një aparat i rëntgenit për nevojat e QMF V, në lagjen “Dardania”, ku do te afrohen shërbimet e radiologjisë në këtë QMF. Është blerë një autoambulancë me pajisje mjekësore për nevojat e QMU-së, dhe është aktivizuar shërbimi emergjent në QMF “Kodra e Trimave”. Është rinovuar një pjesë e QKMF-së, si salla e trajnimeve dhe renovimi i katit të parë të QKMF-së, e cila tashmë është funksionalizuar. Renovime dhe investime ka pasur edhe ne ambulancën në fshatin Bardhosh, në Qendrën e Mjekësisë Urgjente në Prishtinë, në QMF V në lagjen “Dardania” si dhe ne lagjen “Mati”. Po ashtu janë blerë pajisje mjekësore për nevojat e QKMF-së dhe QMU-së, si: aparate laboratorike – biokimike, hematologjike, pajisje për nevojat e stomatologjisë, karrige stomatologjike.
Ambulanca mobile për pensionistët dhe personat që nuk mund të vizitohen në QMF	Kjo nuk është realizuar dhe nuk ka pasur ndonjë kategorizim të veçantë të ofrimit të shërbimeve mjekësore. Ngjashëm qëndron gjendja edhe sa i takon ofrimit të shërbimeve të veçanta për personat me aftësi të kufizuara.
Ngritjen e Spitalit të Qytetit	Nuk ka pasur ndonjë nismë konkrete për përmbushjen e kësaj pike. Parimisht krerët e Prishtinës e patën paraparë ish kazermën e TMK-së në fshatin Llukar për adaptimin e spitalit të qytetit. Në tri vitet e kaluara nuk ka pasur buxhet të alokuar me qëllim të parapërgatitjes për ngritjen e spitalit të qytetit. Spitali i qytetit, si institucion i mjekësisë sekondare, është kompetencë e nivelit qendror, përkatësisht Ministrisë së Shëndetësisë.
Partneritet me QKUK-në në	Nuk ka pasur asnjë marrëveshje ndërmjet QKUK-së dhe Komunës së Prishtinës për realizimin e këtij

<p>funkcion të regjenerimit të hapësirës brenda dhe jashtë lokacionit të QKUK</p>	<p>premtimi. Për me tepër relacionet në mes të QKUK dhe Komunës së Prishtinës në disa raste kanë qenë edhe konfliktuoze. Siq është rasti me uzurpimin e rreth 6 hektarëve tokë të QKUK-së nga persona e subjekte të ndryshme. Trajtimi i kësaj çështje nga ana e QKUK-së dhe Komunës së Prishtinës ka qenë refuzuese, përkatësisht Komuna e Prishtinës nuk e ka vlerësuar hapësirën e uzurpuar kompetencë të saj, ndërsa QKUK-ja ka vlerësuar se ajo nuk ka mekanizma për t'i trajtuar këto lloj problemesh.</p>
<p>Banim social për personat dhe familjet e pastreha</p>	<p>Është arritur të ndërtohet një objekt me gjithsej 50 banesa e lagjen “Gollapi” për t’u shpërndarë për rastet e rënda sociale në kryeqytet si dhe ndaj familjeve të llogaritura të pastreha. Procesi i ndarjes i ka paraprirë miratimi i një rregullore komunale e cila i ka precizuar kriteret dhe procedurat e ndarjes se këtyre banesave. Një komision në përbërje prej pesë personave të cilët e kanë hartuar listën përfundimtare të atyre që do t’i përfitojnë banesat sociale. Dhënia e këtyre banesave është bërë në formën e shfrytëzimit dhe kontrata me fituesit do të shqyrtohet për çdo tri vite. Në konkursin e shpallur nga komuna kanë aplikuar 447 persona apo familje të cilët kanë pretenduar t’i përmbushin kriteret e përfitimit të banesave, për 50 banesa ne dispozicion. Nga të dhënat në terren rezulton se ndarja e këtyre banesave është bërë duke u përfillur kriteret e parapara në rregulloren komunale.</p> <p>Edhe përkundër ndërtimit dhe dhënies së këtyre banesave për kategoritë sociale, akoma në kryeqytet vazhdon të ekzistoj lokacioni i ndërtuar nga barakat ku rreth 22 familje jetojnë në to dhe nuk kanë strehim adekuat. Gjendja e njëjtë paraqitet edhe me rreth 9 familje të tjera të cilët jetojnë në objektet e vjetra të Universitetit të Prishtinës dhe rreth 5 familje të tjera jetojnë në gjendje të njëjtë në një hapësirë të kontestueshme pronësore në lagjen “Kodra e Trimave”. Një numër i konsiderueshëm i familjeve që pretendojnë të mos kenë strehim kërkojnë që gjendjen e tyre ta rregulloj Komuna e Prishtinës, ani pse këto familje janë të ardhura nga qytetet tjera të Kosovës.</p>
<p>Banim social për familje të luftëtarëve, invalidëve të luftës dhe veteranëve të UÇK-së</p>	<p>Objekti për këto kategori është ndërtuar me 50 banesa në lagjen “Gollapi”, ato akoma nuk janë shpërndarë përfitueseve, konkursi për të aplikuar për to është mbyllur. Komuna ka hartuar një rregullore të veçantë për ndarjen e këtyre banesave. Komisioni është formuar, pjesë e komisionit janë edhe anëtarët e shoqatave të dala nga lufta. Së fundmi Shoqata e Familjeve të Dëshmorëve të Prishtinës ka protestuar para komunës me pretendimin se kriteret e parapara për ndarjen e banesave nuk i favorizon ata.</p>

<p>Përkrahje për klubet, shoqatat dhe format e ndryshme të organizimit të të rriturve dhe të rinjve nga fusha e kulturës</p>	<p>Komuna përkrah klube, shoqata, organizata dhe individ të ndryshëm në sferën e kulturës, sportit dhe aktiviteteve të tjera. Asnjëherë nuk është bërë e qartë se cilat janë kriteret mbi baza të cilave përkrahën këto aktivitete dhe çka e bënë që një aktivitet të përkrahjet dhe çka që një aktivitet tjetër të mos përkrahjet. Kësisoj gjatë tri viteve janë përkrahur në fushën e kulturës 240 botime të ndryshme, rreth 20 veprimtari teatrale, 30 festivale kombëtare e ndërkombëtare, 14 projekt të arteve pamore apo ekspozita, janë përkrahur rreth 10 projekte të teatrit “Dodona”, përkrahje ka pasur edhe në projekte për çështjet gjinore, të fëmijëve, projekte nga qendra kulturore e fëmijëve të Prishtinës e kështu me radhë. Shuma totale e mjeteve të shpenzuara për tri vite në përkrahjen e aktiviteteve kulturore kap shifrën e rreth 400 mijë eurove.</p>
<p>Pasurimin e bibliotekave ekzistuese me literaturë të re dhe teknologji informatike dhe promovimin e leximoreve dhe bibliotekave në kuadër të objekteve arsimore, në objekte të reja shumë funksionale dhe me qasje publike</p>	<p>Përgjithësisht është punuar në pasurimin e bibliotekave me literaturë të nevojshme. Po ashtu rëndësi i është kushtuar edhe hapjes dhe mirëmbajtjes së bibliotekave të shkollave fillore dhe atyre të mesme. Regjistrimi në këto biblioteka akoma bëhet në sistemin e vjetër klasik, përmes kartonëve të veçantë të cilat më pastaj të dhënat futen në librin e bibliotekës, por jo edhe në ndonjë program të veçantë kompjuterik. Kjo është praktikë në shumicën dërrmuese të shkollave të Prishtinës. Është ndërtuar biblioteka e re të qytetit të Prishtinës “Hyvzi Sylejmani” e cila ka një hapësirë mjaft të gjerë të përshtatshme dhe është pajisur me inventar të nevojshëm bibliotekar.</p>
<p>Fond të veçantë për zhvillimin e rrjetit bibliotekar në komune</p>	<p>Komuna e Prishtinës për çdo vit ka ndarë një fond në vlerë prej 33 mijë eurosh për blerjen dhe shpërndarjen e librave në bibliotekat e shkollave dhe atë të qytetit.</p>
<p>Promovimin e artit publik: caktimin e hapësirave për ekspozim në ambiente të hapura, në sheshet pranë objekteve publike, në</p>	<p>Nuk ka hapësirë të ndarë dhe të paraparë enkas për këtë veprimtari në kryeqytet dhe as që është planifikuar të ketë. Kohë pas kohe disa aktivitete edhe nga fusha e artit lejohen të mbahen në sheshin kryesor të qytetit “Nëna Terezë”, por këto aktivitete zakonisht janë njëditëshe dhe bëhen për ndër të festimit të ndonjë dite apo rasti të caktuar.</p>

<p>sheshet dhe bulevardet primare të qytetit dhe në hapësirat e lira</p>	
<p>Krijimin e zonave të lira të internetit, duke filluar me Parkun e Qytetit</p>	<p>Asnjë zonë e lirë e internetit nuk është krijuar apo ndërtuar në kryeqytet dhe as që ka planifikime të tilla. Kompanitë e telefonisë mobile, “Vala” dhe “Ipko” me inicitivë të tyre kanë vendosur antena me valë të kufizuara të internetit.</p>
<p>Ndërtimin e objekteve të hapura dhe të mbyllura sportive</p>	<p>Në disa zona të kryeqytetit, veçmas në lagjen “Velania”, “Bregu i Diellit” dhe në lagjen “Arbëria” janë ndërtuar terrene të hapura sportive, kryesisht fusha të njohura ndryshe për futboll të vogël dhe volejball. Nuk ka pasur ndonjë nismë deri tani për ndërtimin e fushave të mbyllura të sportit. Në buxhetin e vitit 2012 është paraparë ndërtimi i një fushe patinazhi në formën e objektit të mbyllur, një pishinë dimërore si dhe staza për atletikë në lagjen “Arbëria” si dhe në “Tokebashqe”.</p>
<p>Ndërtimin e kompleksit të fushave sportive në “Fushën e Pajtimit”</p>	<p>Kjo nuk është bërë dhe komuna ka hequr dorë nga bërja e këtyre fushave rekreative –sportive në lokacionin e njohur ndryshe si “Fusha e Pajtimit”. Kjo fushë aktualisht është e mbërthyer nga mbeturinat e ngurta dhe nuk ekziston mirëmbajtja e saj. Heqja dorë nga komuna për t’i ndërtuar këto fusha ka ardhur nga shkakun që Komuna e Prishtinës dhe kompania regjionale e ujësjellësit “Prishtina” kanë pasur mos marrëveshje në lidhje me atë se kujt i takon kjo fushë, të dyja palët kanë aluduar që e drejta është në anën e tyre. Kontestet kanë mbetur akoma të hapura dhe këto kanë ndikuar që puna për ndërtimin e 12 fushave rekreative – sportive të mos realizohet.</p>
<p>Ngritjen e Qendrës Rekreative Sportive në Zonën Ekonomike me partneritet publik privat</p>	<p>Nuk ka pasur ndonjë nismë konkrete nga Komuna në lidhje me këtë premtim. Në planin rregullues për zonën ekonomike i cili akoma nuk është miratuar në Kuvendin e Prishtinës është paraparë edhe ndërtimi i një stadiumi të ri të Prishtinës.</p>
<p>Restaurimin dhe konservimin e pjesëve të vjetra të qytetit, hapësirave pranë objekteve fetare dhe</p>	<p>Ka pasur nisma konkrete në këtë drejtim, por edhe probleme e ngecje evidente. Kësisoj me parat e buxhetit të Komunës së Prishtinës ka filluar dhe është në prag të finalizimit restaurimi i “Xhamisë së Vjetër të Gurit” në kryqëzimin e rrugëve “Agim Ramadani” dhe “Nazmi Gafurri”. Po ashtu nga buxheti i komunës është duke u restauruar hamami i vjetër i qytetit me disa objekte përreth. Leja për</p>

<p>me rëndësi historike</p>	<p>restaurim është dhënë edhe për xhamin e çarshisë, si dhe për sahat kullën. Po ashtu së fundi leja është dhënë edhe për ndërtimin e ish hotel “Union” në formën e tij të dikurshme; për këtë është krijuar edhe një komision i posaçëm mes Komunës së Prishtinës dhe MKRS-së. Ka qenë për t’u kritikuar hapi i Komunës së Prishtinës i cili ka lejuar përkatësisht ka dhënë leje për rrënimin e xhamisë “Hatunije”, e vjetër afro 500 vjeçare e cila gjendet afër tregut të gjelbër në Prishtinë dhe tani në vend të saj është ndërtuar një xhami e re e cila parasheh edhe ekzistimin e lokaleve afariste.</p>
<p>Ndërtimin e aneksit të Pallatit të Rinisë me partneritet publik privat</p>	<p>Në tetor të vitit 2010 Zyra Ndërlidhëse e Komisionit Evropian në Prishtinë kishte paraparë 14.5 milionë euro për t’i investuar në ngritjen e një aneksi te Pallati i Rinisë, por ky donacion me pastaj është tërhequr nga ZNKE prej Prishtinës dhe është dërguar në Mitrovicë. Shkaktar i kësaj tërheqje është bërë mos definimi përfundimtar i pronësisë së Pallatit të Rinisë dhe Sporteve, ngase aktualisht me këtë ndërmarrje menaxhon Agjencia Kosovare e Privatizimit, ndërsa Komuna e Prishtinës ka shfaqur pretendime të hapura për të menaxhuar vetë ajo me atë ndërmarrje. Në pesë vitet e fundit Komuna e Prishtinës nuk ka investuar në Pallatin e Rinisë dhe sipas udhëheqëseve të këtij institucioni në rast që ky pallat nuk do i jepet komunës në menaxhim, atëherë komuna nuk do të lëshojë leje as për rrënim dhe as për riparim eventual të tij.</p>
<p>Kthimin e Pallatit të Rinisë në qeverisje të komunës dhe rekonstruktimi i tij nëpërmjet partneritetit me Komisionin Evropian dhe Qeverinë e Kosovës</p>	<p>Kjo nuk është arritur dhe akoma mbetet e paqartë nëse Komuna e Prishtinës do të arrijë të menaxhoj me këtë ndërmarrje. Përfshirja e Pallatit të Rinisë edhe në Projektligjin e Prishtinës është një nga arsytet për mos aprovimin e këtij ligji në Qeveri dhe Kuvend.</p>
<p>Çerdhe dhe kopshte të reja për fëmijë në çdo lagje të Prishtinës, në partneritet publik privat</p>	<p>Zyra e Prokurimit në Komunë të Prishtinës gjatë vitit 2010 dhe 2011 ka shpallur pesë herë radhazi tenderin për ndërtimin e çerdheve në kryeqytet në partneritet publiko privat, por në asnjërin tender nuk ka pasur të interesuar për të aplikuar dhe për të ndërtuar çerdhe. Komuna e Prishtinës gjatë tri viteve nuk ka ndarë buxheti për të ndërtuar çerdhe, edhe pse ndjehet nevojë e madhe për to nevoja për to në shumë zona të kryeqytetit. Aktualisht Prishtina ka 9 çerdhe publike dhe rreth 11 private. Raporti i Progresit i Komisionit evropian në tetor të vitit 2010 e ka vlerësuar si urgjente çështjen e</p>

	<p>ndërtimit të institucioneve të tilla, madje në këtë raport ishte vlerësuar si kaotike numri i madh i çerdheve private që sipas raportit hapen pa ju nënshtruar kriterëve dhe vlerësimeve të parapara nga ana e institucioneve. Mungesa e çerdheve vërehet veçmas në zonat e periferisë së qytetit, ku aktualisht nuk ekziston asnjë e tillë publike.</p>
<p>Shfrytëzimin e hekurudhës nga Fushë Kosova deri në fshatin Bardhosh si linjë e trafikut urban dhe suburban</p>	<p>Kjo nuk është bërë dhe nuk ka ndonjë indikacion që pritet të bëhet. Ka pasur biseda ndërmjet udhëheqëseve të Prishtinës dhe atyre të hekurudhave në lidhje me këtë ide, si dhe nga ZNKE është kërkuar financimi i studimit të fizibilitetit. ZNKE nuk ka pasur interesim për të përkrahur nismën për studimin e fizibilitetit. Pas kësaj nuk është ndërmarr ndonjë hap i mëtutjeshëm për t'u implementuar apo konkretizuar kjo ide.</p>
<p>Kënde të lojës për fëmijë në çdo lagje, në kuadër të parqeve dhe në hapësira të lira publike në qytet</p>	<p>Një zonë në qendër të Prishtinës, përgjatë rrugës "Hajdar Dushi" ka kënde të lojërave për fëmijë. Të tilla të ngjashme hasen edhe në lagjen "Dardania", "Bregu i Diellit" "Velania". Në asnjë lagje apo zonë tjetër të kryeqytetit nuk hasen këndë të tilla lojërash.</p>
<p>Rekonstruimin e rrjetit të ujit dhe ndërtimin e fabrikës së ujit në Shkabaj</p>	<p>Përgjithësisht është punuar në këtë drejtim, por kompetente për këtë ka qenë kompania regjionale e ujësjellësit "Prishtina" dhe jo Komuna e Prishtinës. Kjo e para gjatë vitit 2010 dhe në gjysmën e parë të vitit 2011 ka punuar në instalimin e gypave të riinjë të ujit të pijes. Për fabrikën e ujit në fshatin Shkabaj është arritur marrëveshja dhe punët për ndërtimin e saj pritet të nisnin me së largu deri në fillim të vitit 2013. Kostoja e ndërtimit të kësaj fabrike kap shifrën e 35 milionë eurove, nga të cilat 5 milionë do i jap Komuna e Prishtinës, 5 milionë ujësjellësi rajonal "Prishtina", 5 milionë Zyra Ndërlidhëse e Komisionit Evropian, ndërsa 20 milionë të tjera do të jepen nga Banka Gjermane për Zhvillim në formë të kredisë së butë për ujësjellësin "Prishtina". Ndërtimi i kësaj fabrike pritet t'i shtojë Prishtinës 150 litra ujë për sekondë. Ndërhryjet e kompanisë rajonale të ujësjellësit "Prishtina" në riparimin apo instalimin e gypave të ujit në territor të Prishtinës janë bërë duke e dëmtuar asfaltin dhe duke mos marr përgjegjësi për riparimin e tij pas dëmtimit. Në të gjitha rastet kjo kompani ka ndërhyrë në asfalt pa kërkuar leje nga Komuna e Prishtinës, por as kjo e fundit nuk ka ndërhyrë asnjëherë për t'i parandaluar apo ndëshkuar format e tilla të sjelljes.</p>
<p>Ngritjen e fabrikës për pastrimin e ujërave të zeza,</p>	<p>Kjo nuk është bërë dhe as që ka pasur nisma apo iniciativa për një projekt të tillë.</p>

<p>në partneritet me komunën e Podujevës, Kastriotit dhe Fushë Kosovës</p>	
<p>Vazhdimin e projekteve të kanalizimit në fshatrat në afërsi të Prishtinës</p>	<p>Kjo përgjithësisht nuk është bërë dhe shumë fshatra në afërsi të qytetit i kanë të drejtuara kanalizimet e tyre në vijën e lumit “Prishtevka”, siç ndodh me fshatin Makovc, Llukar dhe Grashticë. As në buxhetin e vitit 2012 nuk është paraparë ndonjë investim në këtë drejtim.</p>
<p>Përkrahjen e projekteve të NP “Termokos” për rigjenerimin dhe zgjerimin e kapaciteteve të ngrohjes qendrore për nevoja të ndërtimeve ekzistuese dhe ndërtimeve të reja</p>	<p>Kjo përgjithësisht është arritur. Komuna e Prishtinës i ka ndarë 2 milionë euro nga buxheti i vitit 2012 për të përkrahur projektin e ashtuquajtur të kogjenerimit i cili pritet të lidh ngrohoren e qytetit “Termokos” me termocentralet në Obiliq nga e cila do të merret uji dhe avulli i nxehtë për ngrohje. Komuna edhe gjatë sezonit të ngrohjes 2010-2011 dhe asaj 2011-2012 ka ndarë subvencione për këtë ndërmarrje në vlerë totale 1.1 milionë euro për t’i mundësuar “Termokosit” ofrimin e ngrohjes për qytetarët. Por edhe përkundër mbështetjes financiare nga Komuna dhe Qeveria, “Termokosi” nuk ka arritur gjatë dy viteve të kaluara të ofrojë ngrohje stabile dhe të plotë për prishtinasit.</p>
<p>Trajtimin dhe mirëmbajtjen e hyrjeve dhe ashensorëve në objekte banesore</p>	<p>Ashensorët në objektet banesore publike janë jashtë funksionit. Përkundër kërkesave të shumta nga ana e banorëve të këtyre ndërtesave drejtuar autoriteteve komunale prapë gjendja ka mbetur e pa ndryshuar. Ndërtesat përgjatë lagjes “Dardania”, “Ulpiana” ato në qendër të qytetit, përgjatë rrugës së “UÇK-së”, përgjatë rrugës “Rexhep Luci”, “Hajdar Dushi”, “Qamil Hoxha”, “Agim Ramadani”, ndërtesat përgjatë rrugës “Luan Hajradinaj” nuk kanë ashensor funksional. Në disa raste banorët me vetë iniciativë i kanë rregulluar këta ashensor dhe vetë ata e bëjnë mirëmbajtjen e tyre.</p>
<p>Riorganizimin e NP “Pastrimi” dhe kyçjen e konkurrencës private për të ngritur rregullsinë e mbledhjes së mbeturinave dhe nivelin e pastrimit dhe larjes së rrugëve</p>	<p>Riorganizimi i kompanisë “Pastrimi” është bërë në fillim të 2010. Në vazhdimësi ka pasur të përzgjedhura kompani private të cilat janë angazhuar për mbledhjen e mbeturinave si dhe në larjen e rrugëve gjatë sezonit veror dhe heqjen e borës gjatë sezonit të dimrit.</p> <p>Mirëpo, përkundër këtij riorganizimi, mbledhja e mbeturinave dhe pastrimi i rrugëve nuk është në nivelin e duhur.</p>

<p>Zhvillimin e projekteve për riciklim të mbeturinave dhe prodhim të energjisë elektrike nga mbeturinat</p>	<p>Në këtë drejtim nuk ka pasur asnjë iniciativë apo nismë konkrete. Në lagjen “Dardania” nga Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe kompania “Pastrimi” ka nisur së implementuari një projekt i quajtur seleksionimi i mbeturinave, por jo edhe riciklimi i tyre, apo shndërrimi eventual i tyre në ndonjë produkt përgjithësisht të përdorshëm.</p>
<p>Reformë të stafit administrativ: pranim të punonjësve të moshës së re dhe të përgatitur profesionalisht</p>	<p>Në këtë drejtim ka ngecje të theksuar dhe pranimi në punë në Komunë të Prishtinës bëhet pa u shpallur paraprakisht konkurse publike për vendet e lira pune. Kjo ka ndodhur edhe gjatë vitit 2010 edhe gjatë vitit 2011. Gjatë këtyre dy viteve vlerësohen të pranuar në punë në administratën komunale rreth 53 persona, por për asnjërin nga ta nuk ka pasur paraprakisht konkurs të hapur publik. Nga numri gjithsej i të pranuarve në punë në administratën komunale dominon shifra me shkollim të mesëm, pastaj vije ajo me shkollim fillore dhe e treta kategorizohet stafi me arsimim universitar.</p>
<p>Organizimin bashkëkohor të punës me palë në sportele të hapura dhe digjitalizimin e plotë të lëshimit të dokumentacionit (shërbimet e ofiçarisë dhe dokumentet tjera për qytetarë dhe biznese).</p>	<p>Ky premtim është përmbushur në masë të madhe. Në gjysmën e dytë të vitit 2012 është finalizuar një projekt për digjitalizimin dhe modernizimin e administratës.</p>
<p>Riorganizimin e inspektionit në përputhje me nevojat e Prishtinës dhe përgjegjësitë specifike të drejtorive</p>	<p>Njëra ndër sferat ku me së shumti ka lëvizje në sfat dhe në pozita është drejtoria e inspektionit. Riorganizimi i inspektionit është bërë disa herë radhazi dhe kjo me shumë ka ardhur nga nevoja e ndërrimit të personave ndaj të cilëve ka pasur dyshime dhe aludime të ndryshme për keqpërdorim të pozitës dhe detyrës zyrtare se sa nga nevoja për të ju përshtatur specifikave në terren.</p> <p>Mirëpo, përkundër riorganizimit të inspektoratit, ky sektor i komunës mbetet një ndër më problematikët dhe më jo efikasi.</p>

Ndërtimin e nga një fushe sportive në çdo lagje të qytetit	Kjo nuk është arritur plotësisht. Fusha të tilla janë ndërtuar vetëm në lagjen “Velania” dhe atë “Bregu i Diellit”. Fusha sporti janë ndërtuar në disa oborre të shkollave fillore dhe atyre të mesme, por këto fusha janë të parapara vetëm për nxënës dhe nuk mund të hynë në kategorinë e fushave sportive të lagjes apo lagjeve.
Subvencionimin e bujqve të Barilevës në aktivitetet e tyre të bujqësisë, pemëtarisë dhe perimtarisë	Subvencionim të veçantë për një fshat nuk ka pasur, subvencionimet kanë qenë të hapura për të gjithë bujqit apo pemëtarët e Komunës së Prishtinës.
Ndarjen e bursave për nxënës dhe studentë duke filluar nga viti 2011	Komuna e Prishtinës nuk e ka ndarë asnjë bursë për student apo nxënës dhe nuk ka pasur konkurse të tilla.
Ndërtimin e Prishtinës së Re me baza bashkëkohore të ndërtimit	Në zonën e quajtur “Prishtina e Re” ndërtimet e bëra nuk kanë pasur leje paraprake për ndërtim, gjë kjo e cila e ka ekspozuar atë zonë degradimit dhe ndërtimit pa kriter. Përveç kësaj, Komuna ende nuk ka filluar hartimin e planit rregullues për atë zonë dhe kjo vështirë që do të mund të përmbushet brenda mandatit ekzistues të kryetarit të Prishtinës.
Përfundimin e asfaltimit të të gjitha rrugëve dhe rrugicave të Prishtinës në dy vitet e ardhshme	Ky premtim nuk është përmbushur në tërësi. Viti i tretë i mandatit aktual e gjenë kryeqytetin me shumë rrugë dhe zona të pa trajtuara në sferën e infrastrukturës. Kësisoj është zona prapa sheshit “Nëna Terezë” hapësirë kjo në dimension të gjerë dhe i frekuentuar shumë nga qytetarët, por e cila vazhdon të jetë në baltë. Rrugë të pashtuara hasen edhe në lagjen “Veterniku”, si dhe në disa pjesë të “Matit”.
Sigurimin e ujit të pijshëm 24 orë për katër vitet e ardhshme	Konkretizimi i hapave për ndërtimin e fabrikës së re të ujit në fshatin Shkabaj ka rritur shpresat që Prishtina do të evitojë problemet evidente me furnizim me ujë të pijes. Aktualisht gjendja paraqitet e njëjtë me fillimin e mandatit aktual të autoriteteve të Prishtinës, përkatësisht pothuajse gjitha zonat e Prishtinës përballen me reduktime të gjata të ujit të pijes si dhe me kapacitet të dobët të ujit, veçmas në banesat kolektive.
Investime në fshatin Keqekoll: investime në	Ka pasur disa investime inkurajuese në fshatin Keqekoll dhe fshatrat përreth në infrastrukturë dhe në ndërtimin e shkollës së re të këtij fshati si dhe riparimin e ambulancës. Por progres dhe investime

<p>rrugë, turizëm, zhvillim ekonomik, rritje të punësimit; shërbime të digjitalizuara administrative ku banorët e kësaj ane nuk do të kenë nevojë që të shkojnë në Komunë por do të marrin dokumentet e tyre me postë</p>	<p>nuk ka pasur për sa i takon zhvillimit ekonomik, nuk ka pasur asnjë projekt të kësaj natyre të nxitur nga komuna. Marja e dokumenteve përmes postës nuk është realizuar asnjë herë.</p>
<p>Ndërtimin e rrjetit të shkollave të mesme në periferi të qytetit</p>	<p>Deri tani tri shkolla të mesme janë ndërtuar apo janë duke u ndërtuar, të gjitha në periferi të qytetit. Një e tillë është realizuar në lagjen “Gollapi” një tjetër në lagjen “Kalabria” si dhe tani pritet nisja e punimeve në ndërtimin e shkollës së mesme tek fabrika e tjegullave në Prishtinë, përkatësisht mes lagjes “Kodra e Trimave” dhe lagjes “Arbëria”.</p>
<p>Përcaktimin e mjekut familjar sipas zonave</p>	<p>Kjo nuk është arritur dhe në terren nuk është ndarë në baza të mjekut familjar, por mbi baza të konfiguracioni të terreni dhe mbulushmërisë së tij nga ana e QMF dhe ambulancave.</p>
<p>Furnizimin e rregullt i QMF-ve me barna</p>	<p>Mungesa e barnave dhe mjeteve tjera esenciale për ofrimin e shërbimeve mjekësore në QMF- është evidente dhe e përditshme. Kjo haset në të gjitha QMF ku pacientët detyrohen që për ofrimin e shërbimeve të dalin në barnatoret me të afërm dhe t’i blejnë mjetet e nevojshme për trajtimin e tyre nga ane mjekeve.</p>
<p>Ulje të tarifave për zejtarët</p>	<p>Tarifat në kryeqytet në rrafshin e bizneseve janë përgjithësisht të njëjta apo të ngjashme dhe nuk shihet ndonjë subjekt i favorizuar në bazë të rregullores për tarifa dhe gjopa komunale. Kësisoj zejet e caktuara dhe tradicionale në kryeqytet (teneqe punuesit, këpucëtarët, përpunuesit e drunjve, etj.) kanë tarifa vjetore në vlerë prej 125 - 150 euro, shumë kjo e ngjashme që paguajnë edhe shitoret e tekstilit dhe atyre për shitjen e mallrave ditore me dimension deri në 75 metra katrorë.</p>
<p>Themelimi i Policisë Ndërtimore</p>	<p>Ende nuk ka asgjë konkrete rreth konkretizimit të kësaj ideje. Përfaqësuesit e MPB të qeverisë së Kosovës kanë deklaruar se një gjë e tillë nuk ka mbështetje ligjore dhe rrjedhimisht edhe nuk mund</p>

	të realizohet.
Themelimi i fondit për pensionim të punonjësve të administratës, të cilët dëshirojnë të pensionohen para kohe	Komuna asnjëherë nuk ka iniciuar nismën për formimin e një fondi të veçantë i cili do të mundësonte realizimin e këtij premtimit, për më tepër rregullat ligjore në fuqi nuk e mbështesin pensionimin e parakohshëm me vetë iniciativë të punësuarit.
Organizimi më i mirë dhe modernizimi i transportit publik dhe operatorëve privatë	Edhe më tutje transporti publik përballet me probleme të shumta, si operatorë të vjetruar transportues të cilët nuk i plotësojnë as kushtet elementare për transport, ndodh të jenë të mbi ngarkuar, pa klimë në verë dhe pa ngrohje në dimër, me pamje të vjetruar që i japin një shëmti qytetit. Ka pasur disa aksidente serioze gjatë 2010 të komunikacioni të ardhura kryesisht nga shkaku i gjendjes jo të mirë teknike të autobusëve të “Trafikut Urban”. Përgjatë gjithë vitit 2011 punëtorët e kësaj ndërmarrje e kanë bojkotuar punën dhe kanë protestuar dhjetëra herë para organeve të Komunës së Prishtinës që kësaj ndërmarrje t’i dedikohet ndihmë financiare, gjë të cilën komuna nuk e ka bërë. Edhe pse Kuvendi i Prishtinës ishte bërë garantuese e kredisë që “Trafiku Urban” synonte të tërhiqte nga NLB Bankë, prapë kjo bankë dhe bankat tjera kanë refuzuar t’i japin kredi kësaj ndërmarrje, pas vlerësimeve se kjo ndërmarrje nuk ka fuqi financiare për t’i përballur kredisë dhe kësteve mujore të kthimit. Në gjysmën e dytë të muajit shkurt 2012 disa ekspert amerikan të paguar nga USAID-i dhe të ftuar nga Komuna e Prishtinës kanë nisur një studim se çka duhet të bëhet me ndërmarrjen e “Trafikut Urban” dhe këta ekspert pritet që gjatë muajve në vijim të dalin me vlerësimet e tyre.
Largimi i rrethojave të institucioneve publike	Isa Mustafa pati premtuar se do të largoj rrethojat dhe do të zëvendësoj rrethojat e hekurta dhe parmakët në qendër të qytetit me rrethoja të gjelbërta – me lule. Nuk është ndërmarrë asgjë në këtë drejtim. Për më tepër projekti për sheshin “Ibrahim Rugova” parasheh që rrethojat e Kuvendit dhe ato të Qeverisë të largohen dhe hapësira e rrethuar t’i dedikohet shesheve. Punët për këtë shesh kanë nisur, ndërsa rrethojat nuk janë larguar dhe sipas zyrtarëve komunal mundësia që ato të largohen është e vogël, ngase udhëheqësit e institucioneve qendrore e arsyetojnë mbajtjen e tyre me çështjet e sigurisë. Ngjashëm është situata edhe në hapësirën e cila pritet të ndërtohet sheshi “Zahir Pajaziti” ku rrethojat e vëna nga UNMIK-u nuk janë larguar akoma.

12. Sfidat më të mëdha me të cilat përballet komuna e Prishtinës

Aktualisht, në bazë të vlerësimeve të GAP-it të nxjerra nga bashkëbiseduesit dhe me akterë që i njohin zhvillimet në kryeqytet, rezulton se kryeqyteti ka gjashtë probleme akute të cilat njëherazi do të duhet të ishin edhe gjashtë prioritetet për organet komunale:

1. **Zbatimi i planeve rregulluese.** Njëra ndër sfidat kryesore për Prishtinën gjatë viteve në vijim do të jetë zbatimi i planeve të miratuar rregulluese dhe në këtë drejtim deri tani ka pasur ngecje të mëdha dhe shpërfillje të mëdha mes planeve rregulluese dhe projekteve të nisura në terren.
2. **Ndalja e ndërtimeve pa leje.** Njëra ndër problemet me të mëdha që vazhdon të përballet Prishtina është mundësia e subjekteve të ndryshme për të ndërtuar pa leje, qoftë objekte afariste, qofshin ato individuale të banimit. Vetëm në periudhën e pas luftës supozohet të jenë ndërtuar mbi 20 mijë objekte pa leje në kryeqytet dhe kjo del të jetë sfide për autoritetet e Prishtinës edhe gjatë viteve në vijim.
3. **Vonesat në dhënien e lejeve të ndërtimit.** Komuna e Prishtinës do të duhet të gjente mënyra dhe forma për të përsheptuar dhe thjeshtëzuar procedurat për dhënien e lejeve të ndërtimit. Kjo mbetet sfidë e veçanet për autoritetet në kryeqytet, deri tani mesatarja e dhënies se lejeve të ndërtimit në vit nga komuna është sjell rreth 70 të tilla që është katër fish me pak se numri i objekteve të nisura për t'u ndërtuar në kryeqytet
4. **Lirimi i hapësirave të uzurpuara publike.** Komuna e Prishtinës i ka në pjesën dërrmuese të rasteve te evidentuara hapësirat e uzurpuara publike, por deri tani ka pasur aksione simbolike për lirimin e këtyre hapësirave. Lirimi i hapësirave të uzurpuara publike do të duhet të ishte një prioritet për udhëheqjen komunale. Mbi 500 shtëpi llogariten që janë ndërtuar tërësisht në pronën komunale, ndërsa numri i atyre që janë ndërtuar pjesërisht në këtë hapësirë llogaritet të jetë trefish me i madh.
5. **Mungesa e parkingjeve.** Prishtina gjatë viteve në vijim do të duhet të dëshmonte seriozitet në zgjidhjen e njërës ndër problemet akute në komunikacion, siç është mungesa e parkingjeve. Planet komunale në këtë drejtim deri tani me shumë kanë stagnuar apo kanë dështuar se sa që ka pasur ndonjë progres evident. Mungesa e parkingjeve është duke ndikuar edhe në shëmtimin e pamjes së qytetit.
6. **Autobusët e linjave urbane të vjetruara dhe pa kritere për bartje udhëtarësh.** Komuna e Prishtinës deri tani nuk ka ndërmarr asnjë hap në modernizimin dhe rikuperimin e linjave të qarkullimit të udhëtareve dhe përgjithësisht pamja e autobusëve në kryeqytet ofron imazhin e një qyteti të varfër të tipit lindor dhe asnjëri nga autobusët nuk plotëson kushtet e kërkuara teknike për bartjen e udhëtareve. Kjo do të mbetet një sfidë e Prishtinës për vitet në vazhdim.

13. Burimet

1. www.isamustafa.info (faqja zyrtare e internetit e z.Mustafa gjatë fushatës së tij elektorale); Programi i kandidatit për kryetar të Prishtinës, Prof.Dr.Isa Mustafa.
2. Shkrimet dhe storiet për komunën e Prishtinës në gazetat ditore dhe televizione gjatë periudhave të ndryshme kohore të 2009 dhe fillim vitit 2012, si shkrimet e Bekim Salihu dhe Ganimet Klaiqi - "Koha Ditore"; Lendita Canolli "Zëri", Naim Sadiku dhe Adelina Çoçaj - "038 Live"; Rajmonda Zhdrella - "Klan Kosova".
3. GAP. Letërnjoftimi i Komunave - Prishtinë- 2010.
4. ATRC - Përqindja e kënaqshmërinë së qytetarëve me pamjen e qytetit. http://www.advocacy-center.org/Raporti-Opiniononi_i_qytetarëve_lidhur_me_fletushkat-e-bizneseve.pdf
5. Buxheti i Komunës së Prishtinës 2010 - rishikimi i buxhetit në gjysmën e dytë të këtij viti.
6. Buxheti i Komunës së Prishtinës 2011 - rishikimi i buxhetit në gjysmën e dytë të këtij viti.
7. Raporti vjetor i Komunës së Prishtinës për vitin 2010.
8. Raporti vjetor i Komunës së Prishtinës për vitin 2011.
9. Agjencia e Statistikave të Kosovës - Rezultatet preliminare nga regjistrimi i popullsisë ekonomive familjare dhe banesave.
10. Raporti i Auditorit të Përgjithshëm për Komunën e Prishtinës - korrik 2011
11. Raporti vjetor i komunave 2011 - shkurt 2012 - MAPL.
12. Raporti i Bankës Botërore - "Të bësh biznes 2011"
13. Raporti i investimeve kapitale 2010 -2011 nga Drejtoria e Infrastrukturës lokale në Komunë të Prishtinës.
14. Raporti i investimeve dhe shpenzimeve nga Drejtoria e Shërbimeve publike në Komunë të Prishtinës 2011.
15. Raporti i investimeve dhe shpenzimeve nga Drejtoria se Shëndetësisë në Komunë të Prishtinës - Raportet 2010 -2011.
16. Raporti i Punës nga Drejtoria se Administratës në Komunë të Prishtinës - Raportet 2010 -2011.
17. Raporti i investimeve dhe shpenzimeve nga Drejtoria së Arsimit në Komunë të Prishtinës - Raportet 2010 -2011
18. Raporti i investimeve 2010 - 2011 nga Ministria e Infrastrukturës në Qeverinë e Kosovës.
19. Raporti i investimeve dhe shpenzimeve nga Drejtoria se Kulturës në Komunë të Prishtinës - Raportet 2010 -2011.
20. Raporti i investimeve 2010 -2011 nga Ministria e Arsimit - Shkencës dhe Teknologjisë
21. Raporti i investimeve dhe shpenzimeve nga Drejtoria se Urbanizimit në Komunë të Prishtinës - Raportet 2010 -2011.
22. Të dhënat nga Sektori për legalizim të objekteve gjatë viteve 2010 -2011 në Komunë të Prishtinës.
23. Raporti i punës nga Drejtoria Inspektionit në Komunë të Prishtinës - Raportet 2010 -2011.
24. Raportet e punës nga Drejtoria e Financave dhe e Pronës në Komunë të Prishtinës - Raportet 2010 -2011
25. Rregullorja e Komunës së Prishtinës për trajtimin e ndërtimeve pa leje - korrik 2009
26. Manuali për legalizimin e ndërtimeve pa leje ne Prishtinë - mars 2010.